



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT: INFORMALITETI, PRODUKTIVITETI DHE INOVACIONI

Tiranë, Mars 2024

LISTA E SHKURTIMEVE

Ky dokument pune është përgatitur në kuadër të Mbledhjes XXXIII të Këshillit të Investimeve (26 mars 2024) nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, znj. Elida Fara, eksperte Ekonomike, z. Elvis Zerva, Ekspert Ligjor dhe Rregullator, znj. Xaira Shurdha, Eksperte Monitorimi dhe Ndërlidhjes, si dhe me kontributin e ekspertëve të jashtëm, z. Artur Papajani dhe znj. Mimoza Agolli, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, Dr. Diana Leka (Angoni). Mbështeti në redaktimin gjuhësor të materialit, znj. Elisa Lula, Oficere Administrative dhe Komunikimit në Sekretariat.

Falenderojmë për bashkëpunimin në procesin e konsultimit, Ministrinë e Financave, Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Shoqatën Shqiptare të Turizmit (ATA), Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Shoqatën e Ndërtuesve, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Durrës, PwC, KPMG, Ernst & Young, Deloitte, Grant Thornton, Easy Pay, Kadiu Group, Garden Line, si dhe ekspertët e pavarur (znj. Silvana Meko, z. Fatmir Kazazi, z. Gledis Shehu, z. Ledion Shahini, z. Martin Serreqi, z. Ledio Milkani) si dhe 601 kompanitë që u përgjigjën anketës, për bashkëpunimin e tyre të çmuar në përgatitjen e këtij materiali.

AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
ALL	Leku shqiptar
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BP	Ballkani Perëndimor
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Taksave
ERP	Programi i Reformave Ekonomike
KI	Këshilli i Investimeve
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
PBB	Produkti i Bredshëm Bruto
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
RS	Reformë strukturore
SZHB	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve
TADAT	Mekanizmi i Vlerësimit të Administratës Tatimore
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
METODOLOGJIA	7
KONTEKSTI	9
LIGJET KRYESORE NË LIDHJE ME POLITIKËN DHE ADMINISTRIMIN FISKAL	16
GJETJET KRYESORE DHE ANALIZA	19
5.1 ADMINISTRIMI FISKAL	21
5.2 INFORMALITETI	27
5.3 PRODUKTIVITETI, INOVACIONI DHE KONKURRUESHMËRIA	31
5.4 BARRA RREGULLATORE DHE KLIMA E BIZNESIT	39
REKOMANDIME	44
BIBLIOGRAFIA	47
SHTOJCA I	48
SHTOJCA II	68
SHTOJCA III	89
SHTOJCA IV	92
SHTOJCA V	100

HYRJE

Në vitet e fundit, Qeveria Shqiptare i ka kushtuar vëmendje të konsiderueshme përmirësimit të infrastrukturës për të mbështetur ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të) si dhe startup-et. Nëpërmjet miratimit të mekanizmave ligjorë dhe krijimit të disa agjencive shtetërore¹, si Startup Albania, është fuqizuar ekosistemi dhe mjedisi i funksionimit të startup-eve dhe inovacionit, me qëllimin final promovimin e progresit të sipërmarrjes. Përsa i përket nivelit të Konkurrueshmërisë,² Shqipëria ka demonstruar një shkallë të caktuar gatishmërie për të përballuar presionet konkurruese dhe dinamikat e tregut rajonal si edhe të BE-së. Më specifikisht, progresi evidentohet në zbatimin e reformave strukturore në sektorin e energjisë, përmirësimin e infrastrukturës së transportit, nxitjen e digitalizimit në ekonomi dhe arritjen e disa rezultateve më të mira në edukim. Megjithatë, ekzis-

tojnë pabarazi të konsiderueshme midis nivelit të konkurrueshmërisë së Shqipërisë dhe nivelit të konkurrueshmërisë së ekonomive të rajonit dhe të BE-së. Sfida të tilla lidhen me eksperimentizën e kufizuar sipërmarrëse dhe teknologjike, kërkesat e paplotësuara për investime si në kapitalin njerëzor/fizik, nivelet e ulëta të shpenzimeve për kërkim dhe zhvillim dhe një mungesë në rritje të fuqisë punëtore të kualifikuar. Ndërkohë që evidentohet progres në fushën e tregtisë, me një kontribut në rritje të eksportit të shërbimeve në turizëm, nivelet e eksporteve të vendit mbeten ende relativisht të ulëta, veçanërisht në mallra, duke treguar një potencial të pashfrytëzuar në këtë fushë. Avantazhi konkurrues për ekonominë shqiptare ka qenë kryesisht fuqia punëtore me kosto të ulët, e cila ka nxitur rritjen e sektorëve me intensitet të punës. Megjithatë, kjo qasje nuk është më e qëndrueshme, veçanërisht me përkeqësimin e mungesës së aftësive profesionale për shkak të emigrimit. Në të gjithë sektorët, ekziston një sfidë e rëndësishme në gjetjen e punonjësve, duke çuar në rritje të pagave që mund të mos përputhen edhe me përmirësimet në produktivitetin e fir-

¹ Ligji 25/2022 "Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve" (i ndryshuar)

² Progres-Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2023, i publikuar më 8 nëntor 2023

mave. *Rritjet e pagave pa përfitime përkatëse në produktivitet mund të kërcënojnë konkurrencën e një kompanie.* Pa një fokus të njëkohshëm në rritjen e produktivitetit, bizneset mund të përballen me rrezikun e falimentimit. Ndërsa turizmi ka demonstruar një zhvillim pozitiv, është thelbësore të vlerësohet nëse ai ka sjellë vlerë të shtuar në ekonomi në vitin 2023. Shqipëria po vijon me proceset integruese me tregjet rajonale dhe globale, ndërkohë që sipërmarrësit vendas po përballen me sfida të produktivitetit. Këto sfida përfshijnë përshtatjen me standardet më të larta të prodhimit/shërbimit në përputhje me përmbushjen e kërkesave të një tregu më cilësor, përmirësimin e efikasitetit në proceset e prodhimit apo edhe rritjen e cilësisë dhe inovacionit të produktit/shërbimit. Për më tepër, sipërmarrësit duhet të investojnë në trajnime dhe teknologji për të mbetur konkurrues në arenën globale.

Që nga viti 2013, Qeveria shqiptare ka ndër marrë reforma të ndryshme fiskale që synojnë rritjen e të ardhurave, duke rezultuar në një rritje nga 22,2% në 28% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) në vitin 2023, sipas të dhënave zyrtare të publikuara. Këto reforma përfshinin rritjen e taksës progresive mbi punën dhe taksat e korporatave (që variojnë nga 10% në 23%), si dhe të ardhurat e tjera personale dhe akcizat. Nga viti 2017, ndërhyrjet specifike fiskale synonin sektorë prioritarë përmes trajtimeve tatimore preferenciale, si taksat preferenciale për NMVM-të me xhiro deri në 5 milionë lekë dhe përjashtimet nga TVSH-ja për inputet në bujqësi dhe zhvillimin e turizmit. Për më tepër, që nga viti 2021, janë ndër marrë veprime legjislative për të mbështetur bizneset në rimëkëmbjen nga ndikimet e pandemisë COVID-19 dhe tërmeteve, duke përfshirë uljen e taksave mbi

fitimin dhe rregullimet e pragjeve të regjistrimit të TVSH-së.

Theksojmë se niveli i konkurrueshmërisë dhe produktivitetit influencohen si nga ndërhyrjet fiskale ashtu edhe nga qëndrueshmëria e politikës fiskale ndërkohë që një fokus i veçantë duhet t'i jepet edhe mirëadministrimit të të ardhurave si një nga faktorët thelbësorë, që prek konkurrencën e një vendi. Në adresimin e sfidave të sipërmarrësve në lidhje me disponueshmërinë e forcës së punës dhe produktivitetit, është e domosdoshme të merret parasysh krahasimi i niveleve të taksës mbi punën kundrejt niveleve të taksës në ekonomitë rajonale, veçanërisht për sektorët me intensitet të lartë të punës që luftojnë për të përmirësuar produktivitetin e punës.

Duke filluar nga ky vit, Plani i Reformave Ekonomike (ERP) 2024-2026 do të luajë gjithashtu një rol të rëndësishëm si një dokument themelor në kuadrin e Planit të Ri të Rritjes. Ky plan përfshin një fond rajonal prej 6 miliardë eurosh të destinuar për Ballkanin Perëndimor, me një alokim tregues prej afro 1 miliard euro për Shqipërinë. Megjithatë, disbursimi i këtyre fondeve është i kushtëzuar me përfundimin e reformave strukture të përshkruara në ERP.

Objektivi i këtij dokumenti është të *stimulojë debatin brenda Këshillit të Investimeve duke u mbështetur në evidenca mbi sfidat aktuale të produktivitetit të sipërmarrësve dhe të identifikojë dhe prioritetizojë ndërhyrje në fushën ndërsektoriale të politikave fiskale dhe administrimit fiskal, si dhe produktivitetit të firmës.* Ky diskutim ndjek praktikatat më të mira të fiskalizimit dhe ofrimit të shërbimeve elektronike publike dhe synon të identifikojë, në dialog me palët e interesuara, ndërhyrje që do të nxisnin produktivitetin dhe konkurrencën e ekonomisë.

METODOLOGJIA

Analiza mbështetet në një metodologji të gjerë që përfshin:

HULUMTIM NDËRSEKTORIAL

- Konsultimi* i dokumenteve, ligjeve dhe akteve nënligjore, praktikave institucionale dhe kuadrit institucional përgjegjës për administrimin fiskal dhe zhvillimin ekonomik në vend.
- Sinteza e gjetjeve dhe rekomandimeve* të paraqitura në raportet kombëtare dhe ndërkombëtare nga aktorë të ndryshëm për temën e analizuar.
- Përpilimi i komenteve nga komuniteti i biznesit*, duke përfshirë shoqëritë tregtare, dhomat e tregtisë, shoqatat e industrisë, dhe raportet apo indekset e dokumentuara, kombëtare dhe ndërkombëtare. *Gjithashtu, në përgatitjen e analizës, Sekretariati ka marrë në konsideratë diskutimet, ankesat dhe çështjet e ngritura nga komuniteti i biznesit gjatë takimeve me Sekretariatit e KI-së, si dhe të dhënat nga databaza e brendshme për Klimën e Investimeve dhe Çështjet e Biznesit (2015-2023).*

HULUMTIM I DREJTPËRDREJTË


Kërkim cilësor

- Modeli i intervistës gjysmë të strukturuar* për 5 takime të drejtpërdrejta me institucionet qendrore përgjegjëse për kuadrin fiskal dhe zhvillimin ekonomik
- Modeli i intervistës gjysmë të strukturuar* për 12 takime direkte me komunitetin e biznesit të angazhuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Kërkim sasior

- Një anketë e strukturuar* u krye online nga Sekretariati i KI nga janari deri në shkurt 2024. Anketa synonte të identifikonte sfidat kryesore me të cilat përballen sektori privat në fushat e mirëadministrimit fiskal, informalitetit, produktivitetit dhe inovacionit. U plotësuan gjithsej 601 pyetësorë në mënyrë anonime. Të anketuarit përfaqësojnë ndërmarrje në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke përfshirë të gjitha rajonet e vendit (Figura 1).

Figura 1. Profili i kampionit



Burimi: Anketa e Sekretariatit të KI, 2024

KONTEKSTI

Në këtë seksion përfshihen vetëm dokumentet kryesore që parashikojnë masa të drejtpërdrejta dhe veprime konkrete në lidhje me politikën dhe administrimin fiskal, inovacionin dhe konkurrencën. Ekzistojnë gjithashtu disa strategji me lidhje ndërsektoriale me shtyllat e mësipërme, si Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (SZHBI) 2021-2027, si dhe dokumente të tjera në kuadër të bashkëpunimit rajonal (integrimi tregtar, investimet rajonale, lëvizja e lirë, agjenda digjitale, etj.) të cilat mbështesin reformat aktuale kombëtare dhe përpjekjet për inovacion dhe produktivitet, por që nuk i janë nënshtruar kësaj analize.

3.1 VIZIONI I POLITIKËS FISKALE

Dokumenti kryesor i dedikuar që parashikon objektivat e politikës fiskale dhe administratës fiskale është Draft-Strategjia Afatmesme për Mbledhjen e të Ardhurave 2022³ ("draft strategjia"). Dokumenti është ende një draft, i pa miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Draft strategjia pranon *ndër të tjera se vitet e fundit ka pasur ndryshime të shumta dhe të shpeshta në legjislacionin tatimor, duke përfshirë normat tatimore dhe përjashtimet nga taksat. Ndryshimet e shpeshta nuk kanë stimuluar qëndrueshmërinë e sistemit tatimor dhe kanë ndikuar edhe në uljen e performancës në mbledhjen e të ardhurave, por*

në të njëjtën kohë kanë sjellë rritjen e kostove të administrimit nga administrata fiskale, si dhe të kostove të rakordimit/përputhshmërisë së tatimpaguesve. Edhe pse të ardhurat kanë qenë në një trend rritës gjatë viteve të fundit, vihet re se rritja e të ardhurave rezulton në një ritëm në rënie.

Nëpërmjet masave dhe ndryshimeve të parashikuara në politikën dhe administratën tatimore, draft-strategjia synon të rrisë të ardhurat buxhetore me rreth 2.55% të PBB-së për një periudhë pesëvjeçare, 2022-2026, nga të cilat 1.31% do të gjenerohen nga ndryshimet në politikën tatimore dhe 1.24 % e PBB-së duke përmirësuar elementët e administratës tatimore dhe doganore. Drafti gjithashtu nënvizon nivelin e lartë të informalitetit (mosregjistrim, nën-raportim dhe evazion). Për këtë

³ <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/Strategjia-Afatmesme-e-t%C3%AB-Ardhurave-2022-2026.pdf>

arsye të ardhurat tatimore në përqindje të PBB-së në Shqipëri janë ndër më të ulëtat krahasuar me vendet e Rajonit. Në tërësi, draft strategjia parashikon heqjen graduale të përjashtimeve dhe stimujve të parashikuara deri më tani për sektorët dhe kategoritë e tatimpaguesve, duke nënvizuar 6 prioritetet e saj, *mes të cilave edhe uljen e hendekut të përputhshmërisë së TVSH*. Një analizë e shkurtër e ndikimit të TVSH-së në ekonomi si pjesë thelbësore e politikës fiskale jepet në Shtojcën III.

3.2 ERP 2024 - 2026⁴

Programi ka prezantuar tre grupime tematike, fokusuar në *kapitalin njerëzor dhe politikat sociale⁵, qëndrueshmërinë dhe rimëkëmbjen⁶, dhe konkurrueshmërinë*. Dokumenti gjithashtu *rriti rëndësinë e dialogut* me partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht me institucionet ndërkombëtare financiare, me fokus më të madh në plotësimin e zbatimit të reformave. Reformat strukturore (RS) në kuadër të konkurrencës janë *RS #5 Kërkimi dhe inovacioni, integrimi ekonomik dhe përmirësimi i shërbimeve dhe RS #6 Përmirësimi i klimës së biznesit për NVM-të dhe bizneset startup*.

RS #5 Kërkimi dhe inovacioni, integrimi ekonomik dhe përmirësimi i shërbimeve (Në thelb, masa do të përpqet të ndërmarrë disa veprime në periudhën e ardhshme për të thelluar integrimin ekonomik në rajon, si zbatimi i planit të veprimit për CRM-të, barrierat jo-tarifore, sportelet me një ndalesë (Sportel i Vetëm Kombëtar, NCTS)

⁴ ERP 2024-2026

⁵ RS #1 Arsimi dhe aftësitë, RS #2 Qasja në mbrojtje sociale dhe kujdes shëndetësor, dhe rritje të punësimit për grupet e cenueshme

⁶ RS #3 Energjia e rinovueshme dhe tranzicioni i gjelbër, RS #4 Transformimi digjital dhe infrastruktura

dhe rregullat e reja të origjinës bazuar në konventën e rishikuar PEM). Ndërsa masa e reformës **5.2 - Përmirësimi i kapaciteteve institucionale, financiare dhe njerëzore për kërkimin dhe inovacionin**. Nisma e reformës përputhet me qëllimet afatmesme të Qeverisë, siç përshkruhet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030. Strategjia është në harmoni dhe kontribuon në përmbushjen e Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, të miratuar nga Qeveria Shqiptare në vitin 2015. Për më tepër, ajo përputhet me vizionin e artikuluar në Strategjinë Kombëtare për Kërkimin, Shkencën dhe Inovacionin 2023-2030, e cila parashikon që deri në vitin 2030, Shqipëria do të lehtësojë kërkimin shkencor me cilësi të lartë duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. **5.3 - Rritja e përpjekjeve për të luftuar informalitetin qëndron si një objektiv strategjik për Administratën Tatimore, e cila ka përmirësuar vazhdimisht operacionet e saj për të ndjekur me efektivitet këtë objektiv. Thelbi i kësaj nisme përmbledhet si më poshtë: (I) Reduktimi i hendekut të përputhshmërisë në lidhje me TVSH-në; (II) Reduktimi i punës së padeklaruar, nëndeklarimi i pagave; (III) Hetimi i pajustifikuar i pasurisë; (IV) Reduktimi i mashtrimit tatimor; (V) Reduktimi i kostove të pajtueshmërisë dhe rritja e sigurisë tatimore dhe besimi në administratën tatimore; (VI) Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Administrata Tatimore nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të DPT.**

RS #6.1 Përmirësimi i klimës së biznesit për NVM-të dhe bizneset startup - Zh-

villimi i një kuadri ligjor për të mbështetur bizneset startup inovative, për të forcuar rritjen ekonomike dhe për të përmirësuar mirëqenien e popullatës. Brenda këtij konteksti, misioni i strategjisë artikulon një synim të veçantë: krijimin e një modeli të ri ekonomik të bazuar në parimet e sipërmarrjes inovatore. Masa e reformës **6.2 - Zhvillimi i tregtisë elektronike, promovimi i eksporteve dhe ndërkombëtarizimi, rritja e aksesit në financë** - Zbatimi aktual i Strategjisë së Zhvillimit të Bizneseve dhe Investimeve që shtrihet në periudhën 2021-2027, së bashku me Planin e Veprimit për zbatimin e saj nga 2021-2023, shërben si bazë për hartimin e masave shtesë për mbështetjen e bizneseve dhe investimeve.

3.3 VLERËSIME NGA RAPORTET NDËRKOMBËTARE

3.3.1. Raporti i Progresit të BE-së për Shqipërinë 2023

Raporti nënvizon se sfidat kryesore që dëmtojnë klimën e biznesit janë *korupsioni; ekonomia informale dhe konkurrenca e pandershme; mungesa e transparencës në procedurat e prokurimit publik (veçanërisht për partneritetet publiko-private); mungesa e parashikueshmërisë së legjislacionit; burokracia dhe një mekanizëm joefikas i konsultimit publiko-privat*. Përmirësimet në administratën tatimore dhe reformat thelbësore si futja e faturimit elektronik të TVSH-së (“fiskalizimi”), harmonizimi dhe indeksimi dhe digjitalizimi i akcizës u zbatuan me sukses në tre vitet e fundit, por nuk kanë sjellë rritje të raportit të të ardhurave. *Struktura e të ardhurave tatimore ka mbetur e pandryshuar gjatë dekadës së*

fundit, e karakterizuar nga një mbështetje e madhe në të ardhurat nga konsumi dhe të ardhura të ulëta nga tatimi mbi kapitalin dhe kontributet sociale. Shqipëria vazhdoi të ofrojë stimuj për industrinë agropërpunuese e cila përballlet me sfida, duke përfshirë mungesën e fuqisë punëtore dhe nivelet e ulëta të mekanizmit, digjitalizimit dhe inovacionit. Së fundi, raporti parashikon *një organ të pavarur mbikëqyrës me mandat për të vlerësuar rreziqet fiskale dhe për të monitoruar pajtueshmërinë me rregullat ekzistuese fiskale që mbeten për t'u krijuar*.

3.3.2. TADAT⁷

Analiza vlerëson 9 fusha kryesore të rezultateve të performancës të cilat mbulojnë funksionet, proceset dhe institucionet më kritike të administratës tatimore. Në rastin e Shqipërisë, ai vlerëson se: “reformat e rëndësishme në vitet e fundit përfshijnë kalimin drejt fiskalizimit, konsolidimin e menaxhimit të borxhit në tre zyra, përmirësimin e përpunimit të rimbursimeve të TVSH-së dhe pastrimin e detyrimeve të prapambetura, forcimin e regjistrimit të taksapaguesve, zgjerimin e shërbimeve elektronike dhe zhvillimin e projekteve sektoriale mbi informalitetin të bazuara në risk. Megjithatë, mbeten shumë sfida, duke përfshirë stokun në rritje të detyrimeve tatimore, nevojën për të rritur profesionalizmin në funksionin e kontrollit dhe Zyrën e Tatimpaguesve të Mëdhenj, nevojën për një angazhim më të madh të jashtëm me ndërmjetësit dhe përfaqësuesit kryesorë të biznesit, mungesën e mekanizmave të rëndësishëm të reagimit nga palët e interesuara dhe nevojën për të adresuar mangësitë në kuadrin ligjor të rishikimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tatimore.”

⁷ <https://www.tadat.org/performanceAssessmentReports>

3.3.3. FMN⁸

FMN-ja thekson rëndësinë e konsolidimit fiskal të bazuar në të ardhura në vitin 2024 si kritike për të ndërtuar hapësirën fiskale për politikën e viteve të ardhshme. Për më tepër, ai nënvizon se “...masat fiskale neto kumulative të ngarkuara shtesë prej rreth 1½ për qind të PBB-së do të sillnin borxhin publik në një rrugë të qartë rënieje dhe do të ulnin nevojat për financim bruto. Konsolidimi duhet të arrihet përmes një strategjie të shëndoshë të mobilizimit të të ardhurave, së bashku me përfitimet e efikasitetit dhe rialokimin e burimeve në infrastrukturë, arsim dhe përshtatje klimatike. Autoritetet duhet gjithashtu të vazhdojnë të zgjasin maturimet e borxhit dhe të zvogëlojnë varësinë nga borxhi me normë të ndryshueshme. Përparimet konkrete në reformat fiskale që përmirësojnë qeverisjen dhe mbikëqyrjen e ndërmarrjeve shtetërore, duke përfshirë sektorin e energjisë dhe PPP-të, janë çelësi për ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale”.

3.3.4. OECD- Indeksi i Politikave për NVM-ve: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2022^{9 10}
Sipas Indeksit të Politikave të OECD-së për NVM-të - Shqipëria përballë me disa mangësi në konkurrueshmëri dhe NVM-të priren të nënvlerësojnë rëndësinë e mbajtjes së një gjendjeje të shëndetshme financiare dhe reduktimit të shmangies së vendimeve të pasigurta. Informaliteti shquhet

⁸ <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2024/01/12/Albania-2023-Article-IV-Consultation-Press-Release-and-Staff-Report-543731>

⁹ https://www.oecd-ilibrary.org/development/sme-policy-index-western-balkans-and-turkey-2022_d22fdb37-en


¹⁰ [b47d15f0-en.pdf\(oecd-ilibrary.org\)](b47d15f0-en.pdf(oecd-ilibrary.org))

si një pengesë kryesore për avancimin e qëndrueshëm të bizneseve formale dhe rrjedhimisht të ekonomisë në përgjithësi.

3.3.5. BERZH- A mund të konvergojë Ballkani Perëndimor drejt standardeve të jetesës së BE-së¹¹?

Sipas një dokumenti pune rajonal të BERZH-it (shkurt 2024), “problemi themelor për vendet e Ballkanit është produktiviteti i ulët në ekonomi, rezultat i shumë viteve të nën-investimit, institucioneve të dobëta, demografisë së pafavorshme dhe një mjedisi të vështirë biznesi”. Ai sugjeron një qasje me tre drejtime ndaj reformave: qeverisje më të mirë, rritje të aksesit dhe rritje të ekonomisë së gjelbër. Përparësitë e realizimit të këtyre objektivave - dhe kostot që lindin nga vonesa në aspektin e dëmtimit të klimës - janë të njohura tashmë. Ajo që është ndoshta më pak e vlerësuar është potenciali që ka rajoni, veçanërisht në projektet me energji të erës, diellit dhe hidrocentraleve. Një lëvizje vendimtare drejt burimeve të rinovueshme dhe neutralitetit të karbonit, së bashku me rregulloren e duhur, do të forconte qëndrueshmërinë e rajonit ndaj goditjeve të ardhshme të energjisë. Për eksportuesit, kjo gjithashtu do të lehtësonte ose eliminonte përfundimisht pasojat negative të taksave kufitare të karbonit që do të futen së shpejti në BE.

¹¹ <https://www.ebrd.com/news/publications/special-reports/can-the-western-balkans-converge-towards-eu-living-standards.html>



Shqipëria - Përparësitë krahasuese të zbuluara në eksporte dhe pjesa kumulative e këtyre produkteve në eksporte në vitin 2021 (për qind)

3.3.6. Një pasqyrë e sfidave të identifikuar nga komuniteti i biznesit gjatë viteve 2015 – 2023 në lidhje me politikat dhe administrimin fiskal, informalitetin, barrën administrative, produktivitetin dhe konkurrueshmërinë.

Në funksion të evidentimit sistemik të problematikave mbi klimën e biznesit në vend, Sekretariati mban një databazë të brendshme Mbi Klimën e Investimeve dhe Problematika të Biznesit. Aty dokumentohen raste dhe problematika konkrete, përfshirë dhe ato që lidhen me elementet thelbësore të klimës së biznesit sikurse janë: (a) administrimi dhe politikat fiskale; (b) informaliteti dhe format e shfaqjes së tij; (c) sfidat për rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë; (d) inspektimet dhe barra administrative për biznesin. Këto raste janë evidentuar nga takimet direkte, fokus grupe dhe indekset kombëtare dhe ndërkombëtare të vlerësimit të klimës së biznesit gjatë 2015-

2023. Disa prej tyre dhe me interes për qëllimet e kësaj Note Teknike janë përmbledhur më poshtë. Një pjesë e mirë e tyre janë adresuar gjatë këtyre viteve me ndryshimet ligjore dhe praktikat administrative. Paraqitja e tyre më poshtë ndihmon për të analizuar kontekstin historik të reformave, pikënisjen e tyre dhe progresin e arritur ndër vite.

- » **Kontrolle tatimore hakmarrëse (administrimi fiskal, 2023).**
- » **Mungojnë incentivat (heqja e TVSH) për burimet alternative të energjisë së rinovueshme sikurse në Itali (politikat fiskale, 2023).**
- » **Kuadri fiskal në disa raste është problem-favorizon në disa raste informalitetin - Shembull: akciza e gazit të lëngshëm 6 Lek/Litër (drejtësia fiskale, 2023).**
- » **Kreditimi nga bankat është i shtrenjtë (produktiviteti, 2023).**
- » **Skemat e mbështetjes me linjat teknologjike janë pezulluar (produktiviteti, 2023).**

- » Më shumë vëmendje për zgjidhjen e problemeve teknike të fiskalizimit, kostove dhe penaliteve joproporcionale **(fiskalizimi, 2022)**.
- » Konsolidimi dhe zbatimi përfundimtar i procedurave të fiskalizimit **(informaliteti, 2022)**.
- » Moskonsiderimi i shqetësimeve të grupeve të interesit gjatë konsultimit të draftit “Për Tatimin mbi të Ardhurat” **(politikat fiskale, konsultim publik 2022)**.
- » Mosfunksionimi i Shoqatave të Bashkëpunimit Bujqësor- Kuadri rregullator nuk e mbështet funksionimin e tyre **(kuadri rregullator dhe fiskal, 2021)**.
- » Taksat dhe Tarifat vendore për subjektet në fushën e agrobiznesit nuk janë të përshtatshme **(politika fiskale, 2020)**.
- » Mungesa e subvencione për blegtorinë e bën sektorin më pak konkurrues në raport me vendet e rajonit **(politika fiskale, 2020)**.
- » Inspektime të pakoordinuara nga ana e inspektoriateve **(inspektoriate dhe barra administrative, 2019)**.
- » Afati i caktuar për hyrjen në fuqi të këtij ligji nga data 1 janar 2020 konsiderohet si i parealizueshëm dhe i parakohshëm **(fiskalizimi, 2019)**.
- » Iniciativa të tilla ligjore si fiskalizimi duhet të shqërrohen me paketën e akteve nënligjore sepse shpeshherë ndodh që tjetër gjë thotë ligji dhe tjetër gjë thotë udhëzimi **(fiskalizimi, 2019)**.
- » Targetimi i një baraspeshimi të drejtë kosto-përfitim është i domosdoshëm për implementimin e sistemit **(fiskalizimi, 2019)**.
- » Barrierat tarifore dhe jo tarifore, plus kosto e lartë e çmimit të energjisë **(konkurrueshmëria, 2018)**.
- » Cilësia e stafit të administratës është problematike. Njerëz të papërgjegjshëm, me axhenda personale dhe të paafte në pozicione kyçe **(administrata, 2018)**.
- » TVSH-ja e kreditueshme nuk rimbursohet. Ligjet janë por mungon vullneti **(rimbursimi i TVSH-së, 2018)**.
- » Industria përpunuese e mishit: Duhet të hiqet taksa doganore për lëndët e para. (p.sh. mishi i derrit) që gjithsesi nuk prodhohen në vend **(konkurrueshmëria, 2018)**.
- » Pamundësia për eksportimin e produkteve shtazore drejt BE **(konkurrueshmëria, 2018)**.
- » Taksa doganore për lëndët e para që nuk prodhohen në vend si farat e sojes/lulediellit, etj. **(konkurrueshmëria, 2018)**.
- » Udhëzimi Nr. 24 i Ministrisë së Financave nuk i përshtatet si duhet kërkesave praktike që kanë njësitë e shërbimit në turizëm **(kupon, fatura përmbledhëse, pajisjet fiskale, 2018)**.
- » Informaliteti i lartë midis vete tur-operatorëve **(informaliteti në turizëm, 2018)**.
- » Blloqet e faturave të TVSH-së duhet të jenë elektronike **(digjitalizimi, 2017)**.
- » Mosaplikimi për rimbursim të TVSH-së nga frika e kontroleve tatimore **(administrimi fiskal, 2016)**.
- » Interesa të larta dhe kosto të larta administrative nga bankat e nivelit të dytë dhe zyrrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme **(sistemi bankar, 2016)**.
- » Konkurrencë e pandershme nga subjekte që shesin pa fatura tek grosistët **(informaliteti, 2016)**.
- » Kontrole të shpeshta dhe të pajustificuara nga administrata në përgjithësi dhe ajo tatimore në veçanti **(administrimi fiskal, 2016)**.

- » Gjoha të pajustificuara nga sistemi për të vetëpunësuarit e vetëm për mosdeklarim punonjësish **(administrimi fiskal, 2016)**.
- » Kapacitete të dobëta të administratës tatimore - Ka nevojë për trajnim dhe ndryshim mentaliteti **(administrimi fiskal, 2016)**.
- » Informaliteti në punësim nga konkurrenca e pandershme - Konkurrentët nuk paguajnë sigurime shoqërore **(informaliteti, 2016)**.
- » Legjislacioni është i ngatërruar dhe ka mbivendosje që justifikojnë një rishikim të plotë të tij sipas një modeli evropian **(legjislacioni, 2016)**.
- » Kontrollat tatimore jo të argumentuara dhe komunikimi i dobët i administratës tatimore **(administrimi fiskal, 2016)**.
- » Nuk ka manuale të thjeshta shpjeguese për segmente të caktuara tatimpaguesish (p.sh. biznesi vogël) që t’iu lehtësojë pajtueshmërinë me legjislacionin **(administrimi fiskal, 2015)**.
- » Përgjigje të dobëta dhe aspak sqaruese nga administrata tatimore lidhur me pyetjet dhe çështjet e ngritura nga bizneset **(administrimi fiskal, 2015)**.
- » Vlerësimi i punës së administratës tatimore bëhet mbi bazën e rivlerësimeve tatimore ku përfshihen dhe gjocat e vendosura ndaj bizneseseve **(administrimi fiskal, 2015)**.

LIGJET KRYESORE NË LIDHJE ME POLITIKËN DHE ADMINISTRIMIN FISKAL

Më poshtë trajtohen ligjet kryesore që parashikojnë rregullat dhe procedurat fiskale si dhe taksat/tatimet që duhet të paguajnë tatimpaguesit.

1) *Ligji 9920/2018 “Për procedurat tatimore” (i ndryshuar).*

Ligji për procedurat tatimore dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, veçanërisht udhëzimi i Ministrit të Financave 24/2008 rregullojnë procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore, parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë, etj. Ky ligj, përcakton parimet bazë mbi të cilat mbështetet sistemi tatimor shqiptar dhe administrimi i tij. Që nga miratimi i tij në 2008, ligji është rishikuar më shumë se 23 herë. Këto ndryshime kanë ndryshuar në thelb dispozitat e tij fillestare në masën që kanë prekur pothuajse të gjitha nenet e ligjit sipas versionit origjinal. Ndryshimet e vazhdueshme kanë prekur parimet kryesore si vetëdeklarimi. Vetëvlerësimi (vetëdeklarimi) është ku-

fizuar si e drejtë e tatimpaguesit, ndërkohë që administratës tatimore i jepet gjithnjë e më shumë hapësirë përdorimi i metodave alternative për vlerësimin e detyrimit tatimor për t’u paguar. Në fakt, numri i metodave alternative në dispozicion të administratës tatimore është pothuajse dyfishuar që nga viti 2008, nga 8 në 15. Administrata mund të rregullojë dhe rivlerësojë situatën tatimore me iniciativë të njëanshme në shumë raste. Gjithashtu, herë pas here janë parashikuar gjopa joproporcionale, duke krijuar mbivendosje dhe pasiguri si për tatimpaguesit ashtu edhe për administratën gjatë zbatimit.¹² Disa koncepte duhen riorganizuar në thelb, ndërkohë që udhëzimi

12 Për shembull në nenin 121 parashikohet se “... Tatimpaguesit me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi fitimin korporativ, që mbajnë në ruajtje, përdorin ose transportojnë mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore penalizohen me gjobë 750 000 lekë. Në praktikë probabiliteti është më i lartë që të rezultojnë diferenca minimale në inventarin e një shoqërie, sidomos në mallra me cmime inferiore. Penaliteti në fjalë është jo në proporcion me vlerën e mallit të munguar, qoftë edhe një dëmi të shkaktuar. Nga ana tjetër është evident rreziku i shfaqjeve korruptive, nga vendosja e penalteteve të tilla.”

24/2008 në shumë raste parashikon rregulla përtej atyre të parashikuara nga vetë ligji,¹³ në kundërshtim me parashikimet e ligjeve të tjera, si ligji 9901/2008 “Për subjektet tregtare dhe tregtare” dhe jo në përputhje me praktikën e biznesit (p.sh. rregullat për bizneset që operojnë në sektorin e turizmit).¹⁴ Për më tepër, procedurat tatimore gjatë këtyre viteve i janë nënshtruar një sërë proceseve dhe reformave si p.sh.: sistemi e-tax, fiskalizimi, aksionet anti-informalitet, etj., të cilat kërkojnë tanimë dispozita adekuate ligjore për zbatimin e saktë.

2) *Ligji 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar)*

Ligji për tatimin mbi të ardhurat dhe aktet ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të tij, rregullojnë marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave. Ai përcakton rregullat për mbledhjen dhe administrimin e tatimit mbi të ardhurat personale të individëve, të tatimit mbi fitimin për shoqëritë tregtare si dhe të personave fizikë (tregtarë të regjistruar), kur janë subjekt i tatimit mbi fitimin. Ky ligj u miratua mes debateve publike lidhur me instrumentet e zgjedhura për të trajtuar disa lloje të shmangies së taksave dhe konceptet e reja të prezantuara, të cilat preknin kryesisht një grup specifik biznesesh të vogla, si p.sh. ofrimin e shërbimeve nga

13 Një shembull ishte miratimi i udhëzimit ndryshues nr. 44 datë 9.11.2020 të udhëzimit 24/2008, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 197, datë 12.11.2020, i cili “përkeqësoi” dispozitat për bllokimin e llogarive për tatimpaguesit. Gabimi u rregullua me ndryshimet që u bënë me udhëzimin nr. 45 datë 26.11.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 210, datë 02.12.2020.

14 Shumë nga këto paqartësi janë zgjidhur herë pas here në praktikë nëpërmjet një angazhimi reaktiv nga palët e interesuara si shoqatat e turizmit dhe DPT, por përafrimi i plotë kërkon miratimin e rregullave të qarta që mundësojnë parashikueshmëri dhe siguri për të dyja palët.

profesionistët në treg. Megjithatë, ndryshimet e vazhdueshme në legjislacion, veçanërisht ato që parashikojnë rregullat fiskale, krijojnë pasiguri dhe vazhdojnë të jenë një shqetësim i vazhdueshëm për bizneset. Zbatimi i rregullave fiskale kërkon një konsensus të madh paraparak nga të gjithë aktorët dhe një planifikim të mirë si premisa për zbatimin e suksesshëm. Këtu vlen të theksohet mungesa e koordinimit në kohë ndërmjet miratimit të masave ligjore dhe infrastrukturës operacionale dhe institucionale që bën të mundur zbatimin efektiv të kuadrit rregullator pa paqartësi të mëtejshme. Më konkretisht, miratimi i ligjit 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, pa hyrë ende në fuqi, është ndryshuar me akt normativ¹⁵ për shkak të mos qenies gati dhe mungesës së kohës në dispozicion që administrata tatimore të përgatiste formularët e rinj në sistemin elektronik të taksave. Siç e kemi nënvizuar edhe në të kaluarën, zbatimi efektiv i kuadrit rregullator dhe rritja e përputhshmërisë së biznesit me të, kërkon si parakusht një marrëdhënie transparente dhe kohë të mjaftueshme për testimin e sistemeve që, siç dëshmohet, ende nuk janë konsoliduar. Hyrja e ligjit në fuqi ka shkaktuar pasiguri në praktikë si për tatimpaguesit ashtu edhe për administratën tatimore. Ndërkohë pritet edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese mbi kushtetueshmërinë e disa neneve të tij, për të sqaruar përfundimisht mënyrën e zbatimit në praktikë të ligjit.

3) *Ligji 92/204 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (i ndryshuar).*

Ky ligj përcakton zbatimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) është një tatim i

15 Akti-normativ nr. 7 datë 13.12.2023.

përgjithshëm mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve, proporcional me çmimin e tyre, që i ngarkohet çdo faze të prodhimit dhe procesi të shpërndarjes me çmim të patatuar. Ligji aktual 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” është hartuar në kuadër të Projektit IPA 2007 “Mbështetje për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të Shqipërisë” për përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis*. Ligji i është nënshtruar disa ndryshimeve të cilat kanë përshtatur ndryshimet në politikën fiskale në lidhje me pragun për qëltime të TVSH-së dhe procedurat specifike për të adresuar disa çështje gjatë administrimit të TVSH-së, si ato që kanë të bëjnë me procedurat për rimbursimin e TVSH-së për kategori të caktuara (p.sh. paketa e eksportuesve). Nga ana tjetër, ndryshimet e vazhdueshme të TVSH-së së aplikueshme për efekt kompensimi të fermerëve (6%, 14%, 20%, 0 %, 6%, etj.) në aktet nënligjore kanë qenë të shpeshta dhe dëshmojnë për gjetjen e zgjidhjeve jo të qëndrueshme dhe afatgjata duke përforcuar kështu domosdoshmërinë e analizave të plota sektoriale, përpara ndryshimit dhe zbatimit të tyre dhe matjen *a posteriori* të impaktit të tyre.

4) Ligji 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar)

Ky ligj, në dispozitat e tij, përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore për shlyerjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Ligji, në mënyrë të detajuar, përveç strukturës, përcakton çdo taksë vendore që administrohet

nga njësia e administratës vendore. Ai përcakton qartë administrimin e tij, duke filluar nga mënyra e llogaritjes dhe personat përgjegjës për pagesën e taksës dhe mbledhjen e saj. Një vend të veçantë zë trajtimi në detaje i mënyrës së administrimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, përkatësisht përcaktimi i tatimpaguesve që i nënshtrohen tatimit, rregullat e mbajtjes së dokumentacionit, rregullat për përcaktimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tatueshme, norma tatimore, si dhe deklarimi dhe pagesa e tatimit. Ligji, përveç përcaktimit të tarifave vendore, u ka dhënë njësive të qeverisjes vendore atributin për vendosjen e taksave të përkohshme, gjë që ka qenë objekt debati publik, veçanërisht në rastin e Bashkisë së Tiranës (p.sh. taksa për infrastrukturën arsimore). Sekretariati ka analizuar në të kaluarën çështje lidhur me zbatimin e taksave në nivel lokal dhe ka rekomanduar harmonizimin e legjislacionit për taksat dhe tarifatat vendore me legjislacionin e ri për financat e vetëqeverisjes vendore.¹⁶ Korpusi i legjislacionit në lidhje me politikën fiskale dhe elementet e administrimit fiskal përmban shumë ligje dhe akte nënligjore të tjera të cilat zbatohen nga tatimpaguesit dhe administrata tatimore, si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor. Vlen të përmenden këtu disa prej tyre, si ligji 54/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të zhvillimit teknologjik dhe ekonomik” dhe ligji 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve” (i ndryshuar). Ato parashikojnë lehtësi, përjashtime dhe stimul fiskalë për lloje të caktuara investimesh dhe kategori si p.sh. nomadët digjitalë, etj.

¹⁶ https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2020/04/EN_Technical-Note.pdf

GJETJET KRYESORE DHE ANALIZA

GJ

etjet e paraqitura në këtë dokument pune burojnë nga një analizë e çështjeve të ngritura nga komuniteti i biznesit. Për të siguruar një perspektivë të plotë, këto gjetje u diskutuan paraprakisht me institucionet përkatëse përgjegjëse për adresimin dhe zgjidhjen e tyre dhe u grupuan në pesë shtylla:

(a) Mirëadministrimi Fiskal; (b) Informaliteti dhe konkurrenca e pandershme; (c) Produktiviteti i ndërmarrjeve; (d) Inovacioni dhe Konkurrueshmëria; dhe (e) Barra rregullatore dhe klima e biznesit.

Burimet kryesore që identifikojnë këto gjetje përfshijnë: (i) Perceptimet e biznesit të mbledhura nga pyetësorët e plotësuar nga 601 kompani, ku 28% janë gra sipërmarrëse; (ii) Takime konsultimi të mbajtura ndërmjet shkurtit dhe marsit 2024 me firma konsulence të specializuara në çështjet tatimore dhe ligjore, ekspertë të industrisë, dhomat e tregtisë, shoqatat tregtare, bizneset dhe institucionet; (iii) Analiza e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës, së bashku me raportet vjetore nga institucione si DPT; (iv) Pikëpamje nga drafti i Strategjisë Afatmesme të Mbledhjes së të Ardhurave.

Disa gjetje trajtojnë çështje të diskutuara më parë në takimet e KI, si (i) Ndryshimet e shpeshta në legjislacionin fiskal dhe tatimor dhe miratimi jo në kohë, duke çuar në sfida zbatimi dhe vështirësi përputhshmërie si për të dyja administratat ashtu edhe për bizneset, duke penguar parashikueshmërinë dhe përshtatshmërinë; (ii) Mungesa e koherencës ndërmjet dispozitave ligjore në fuqi, si ato që kanë të bëjnë me procedurat tatimore, sistemin e taksave vendore, për tatimin mbi të ardhurat, si në nivel ligjor ashtu edhe në nivel aktesh nënligjore; (iii) Fragmentimi brenda sistemit tatimor që kontribuon në pabarazitë e perceptuara fiskale; (iv) Nevoja që ndërhyrjet të maten jo vetëm në terma buxhetorë, por edhe në ndikimin e tyre më të gjerë; (v) Kapacitete të pamjaftueshme institucionale për të menaxhuar sfidat në rritje dhe kompleksitetin e çështjeve tatimore dhe fiskale; (vi) Rëndësia e reformave të strukturuar dhe të qëndrueshme me kalimin e kohës, veçanërisht në fushat e derregullimit dhe inspektimit; (vii) Nevoja për koordinim institucional në krijimin e një mjedisi miqësor ndaj biznesit.

PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE KRYESORE TË ANKETIMIT DHE DISA KONSIDERATA

- » Përmirësimi i informimit/komunikimit (2019-2024): Komunikimi me administratën tatimore është përmirësuar disi dhe trendi është i qëndrueshëm.
- » Digjitalizimi i mirëpranuar – Biznesi shprehet i kënaqur me shërbimet elektronike krahasuar me vitin 2022, edhe pse ka ende vend për përmirësim, kryesisht në elementët e besueshmërisë së të dhënave dhe shërbimit ndaj klientit.
- » Reforma e fiskalizimit - Ka pasur një rritje të vlerësimit për sa i përket shërbimit ndaj klientit në sistemin e fiskalizimit, duke u rritur nga viti 2022. Megjithatë, ende shprehet nevoja për ekzistencën e një kanali komunikimi (call center) për të mbështetur përdoruesit. Fiskalizimi vlerësohet në ndikimin e tij në uljen e informalitetit në vend por me kosto të shtuara për bizneset.
- » Rritja e trajnimit ligjor – Biznesi ka rritur pjesëmarrjen në trajnimet e DPT-së, megjithëse ende në nivele të ulta.
- » Perceptimi mbi informalitetin – Në një masë të konsiderueshme, bizneset pranojnë ekzistencën e informalitetit, më shumë se në vitin 2019 por më pak se në vitin 2022. Bujqësia, Industria përpunuese, Shërbimet dhe Turizmi perceptojnë më shumë Informalitet. Energjia percepton më pak informalitet krahasuar me sektorët e tjerë. Informaliteti në formën e tij më të lartë shfaqet si evazion fiskal, punë në të zezë dhe mosregjistrim, trend i ruajtur ndër vite.
- » Faktori më i rëndësishëm që nxit informalitetin është barra fiskale në nivel qen-

dror për herë të parë që nga viti 2022, ku konkurrenca e pandershme dhe korrupsioni ishin faktorët kryesorë në nxitjen e informalitetit. Sa më sipër mund të shpjegohet me (i) strukturën e bizneseve (95% e përbëjnë bizneset e vogla me xhiro deri në 14 mln lekë), të cilët, në një nivel të konsiderueshëm, do të preken nga miratimi i ligjit 29/2023 “Për të ardhurat Tatimore” dhe taksat e vendosura për veprimtaritë profesionale të shërbimit; (ii) heqja e pritshme e përjashtimeve aktuale me efekt në fund të vitit 2025 dhe në fund të vitit 2029 për disa industri (p.sh. programet kompjuterike, agroturizmi, turizmi, industria e automobilave, etj.) sipas nenit 69 të ligjit dhe për këtë arsye barrë e rëndë tatimore pritet për të ardhmen.


- » Ulja e TVSH-së në turizëm ka ulur informalitetin sipas perceptimit të vetë sektorit.
- » Klima e biznesit është përmirësuar për sa i përket regjistrimit dhe licencimit por jo për sa i përket procedurave/kostove të huamarrjes dhe barrës fiskale në vend.
- » Disponueshmëria e fuqisë punëtore konsiderohet si disavantazhi kryesor në vitin 2024, në një kohë kur në vitin 2022 disponueshmëria ishte faktori i katërt në radhë i konsideruar si pengesë e brendshme për integrimin. Informaliteti konsiderohet ende si pengesa kryesore indirekte e integritetit për kompanitë shqiptare.
- » Produktiviteti – Kompanitë mendojnë se janë po aq produktive brenda vendit, por më pak produktive në krahasim me kompanitë e huaja me të cilët bashkëpunojnë.
- » Trajnimi i vazhdueshëm së bashku me rritjen e pagave mund të sjellë një rritje të pro-

duktivitetit në punë sipas perceptimit të biznesit. Në një masë të konsiderueshme, biznesi ka deklaruar se po merr masa për rritjen e produktivitetit në punë.

- » Rritja e mbështetjes shtetërore për subvencione, trajnime dhe teknologji do të ndihmonte kompanitë në vend të rrisin produktivitetin në punë.
- » Inovacioni është konsideruar se ka marrë një vëmendje të konsiderueshme nga kompanitë gjatë vitit 2021 (periudha pas pandemisë), megjithëse i pambështetur me një fond të dedikuar, krahasuar me vitin 2024. Kompanitë, në shumicën e rasteve, trajnojnë punonjësit bazuar në nevojat e momentit dhe nuk kanë një linjë të vazhdueshme buxheti të dedikuar për këtë.
- » Barra Rregullatore si një kosto shtesë për biznesin vlerësohet në masë të madhe të jetë e lidhur me barrën fiskale dhe inspektoratet – numri i tyre, moskoordinimi dhe shpeshtësia e inspektimeve.

5.1 ADMINISTRIMI FISKAL

Figura 3. Komunikimi me Administratën Tatimore (DPT)



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

A. Ndërsa ekziston një konsensus për përmirësimin e komunikimit dhe ndërveprimet me administratën tatimore qendrore, sektori privat mbetet i shqetësuar për stabilitetin e politikave fiskale, cilësinë e komunikimit fiskal (vendimi tatimor)/interpretimi teknik i legjislacionit dhe profesionalizmi i administratës.

- (1) *Një rritje e lehtë në tendencat pozitive është vërejtur në ndërveprimet fillestare të biznesit me administratën tatimore (2019-2024).* Një në dy biznese beson se komunikimi me administratën tatimore është përmirësuar gjatë dy viteve të fundit dhe kjo tendencë ka mbetur relativisht e qëndrueshme me kalimin e kohës. Kur merret parasysh madhësia e kompanisë, situata duket kryesisht e ngjashme, megjithëse kompanitë e vogla mund të perceptojnë dallime të vogla në përkeqësimin e komunikimit. *Kjo prirje i atribuohet kryesisht reduktimit të ndërveprimit njerëzor që rrjedh nga rritja e shërbimeve të digjitalizuara.*

(2) Nga takimet e zhvilluara me sektorin privat, është shfaqur një shqetësim i theksuar tek bizneset lidhur me cilësinë e kontrollit tatimor, shpjegimet ligjore dhe teknike dhe opinionet (vendimet tatimore) të dhëna nga administrata tatimore për çështjet e ngritura nga bizneset. Çështjet e përsëritura të përgjigjeve të vonuara, që kërkojnë kohë, jo të plota dhe/ose jokonsistente ndaj çështjeve tatimore të ngritura nga tatimpaguesit janë çështjet më të përhershme të theksuara nga biznesi, të cilat çojnë në përshkallëzim të kostove të pajtueshmërisë tatimore, vonesa dhe mungesë sigurie për shkak të dyshimeve. Në analizën tonë, kërkohet transparencë më e madhe në bërjen publike dhe lehtësisht të aksesueshme të manualeve dhe vendimeve tatimore, për shembull, vendimet/udhëzimet ligjore dhe teknike për çështje specifike tatimore të tatimpaguesve, të cilat mund të shërbejnë si një mjet për unifikimin e praktikave administrative tatimore, dhe përmirësimi i pajtueshmërisë tatimore pa kosto të mëtejshme dhe/ose ndryshime ligjore. Ky është jo vetëm një detyrim ligjor sipas përcaktimeve të neneve 10, 28 dhe 135 të ligjit

Figura 4. Vendimmarrja në raport me vlerën e ankimeve të marra në shqyrtim

	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
Vlera e ankimeve të lëna në fuqi	381,112,929	80%	359,713,481	65%	365,248,661	62%	509,789,735	73%
Vlera e ankimeve të shfuqizuara	72,762,130	15.32%	156,839,345	28.37%	199,780,251	33.77%	162,451,976	23.24%
Vlera e ankimeve kthyer DRT-ve	21,083,985	4.44%	36,260,250	6.56%	26,595,725	4.50%	26,717,394	3.82%
Shuma (shfuqizim dhe kthim në DRT)	93,846,115	19.8%	193,099,595	35%	226,375,976	38.26%	189,169,370	27%

Burimi: Drejtoria e Apelimit Tatimor

9920/2008 “Për procedurat tatimore”, të miratuara gjatë viteve me synimin kryesor konsolidimin e precedentëve tatimor, por edhe një mekanizëm lehtësues që rrit përgjegjshmërinë. Në këtë kategori bëjnë pjesë edhe vendimet e strukturave të apelimit tatimor, të cilat janë instrumente efektive për vetëkorrigjimin e administratës dhe tatimpaguesve, ndaj vendime të tilla duhet të publikohen në mënyrë sistematike. Hendeku në legjislacionin e pajtueshmërisë tatimore si nga administrata tatimore ashtu edhe nga tatimpaguesit mund të ekstrapolohet nga të dhënat zyrtare të dhëna nga Drejtoria e Apelimit Tatimor si më poshtë:


Krahasuar me vitin 2015, faqja e internetit e DPT-së është përmirësuar ndjeshëm dhe ofron përmbajtje të dobishme, të përfshira në raportet vjetore të DPT-së, buletinet për vendimet e çështjeve gjyqësore dhe buletinet mbi udhëzimet ligjore dhe teknike. Për sa i përket buletineve të vendimeve/udhëzimeve ligjore dhe teknike, publikimi i fundit përfshin vetëm vitin 2021.

(3) Sipas të dhënave të anketës, *bizneset kërkojnë më shumë seanca trajnimi nga administrata tatimore në lidhje me ndry-*


shimet e fundit ligjore që ndikojnë në aktivitetet e biznesit dhe marrëdhëniet e tyre me administratën. Anketa tregon gjithashtu një rritje të pjesëmarrjes së biznesit në këto sesione trajnimi ndër vite, megjithëse në një nivel relativisht të ulët. Kur kjo prirje u diskutua më tej me DPT-në, ata pranuan një pjesëmarrje të ulët në seancat e tyre të trajnimit që synonin sektorin privat. Megjithatë, u vu re një përjashtim me trajnimet në lidhje me sistemin e fiskalizimit, ku DPT raportoi pjesëmarrje dhe interes më të lartë nga bizneset.

Figura 5. Trajnime mbi legjislacionin tatimor

A keni marrë pjesë në sesione trajnimi të ofruara gjatë viteve të fundit nga administrata tatimore mbi zbatimin e legjislacionit tatimor? (2024)



A keni marrë pjesë në sesione trajnimi të ofruara gjatë viteve të fundit nga administrata tatimore mbi zbatimin e legjislacionit tatimor? Po



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

(4) Krahas dëshirës për t’u angazhuar në trajnime të ofruara nga administrata tatimore, sektori privat shprehu rezerva për cilësinë e komunikimit me personelin ekzistues. Krahas theksimit të domosdoshmërisë për trajnime që synojnë bizneset, sektori privat percepton gjithashtu nevojën për më shumë programe trajnimi paraprake për të rritur aftësitë dhe njohuritë e stafit të administratës tatimore. Kjo mund të stimulohet nga ndryshimet e fundit në legjislacionin fiskal dhe interpretimi praktik i tyre.


B. Sektori privat e ka përqafuar pozitivisht digjitalizimin, duke shprehur kënaqësinë e përgjithshme me shërbimet elektronike. Megjithatë, ka ende vend për përmirësim, veçanërisht në rritjen e besueshmërisë së të dhënave dhe elementeve të shërbimit ndaj klientit.

(5) *Bizneset kanë adoptuar me entuziazëm digjitalizimin e shërbimeve tatimore publike, duke theksuar kursimin e kohës dhe reduktimin e kontaktit njerëzor si aspektet më të dobishme.* Sipas perceptimit të tyre, elementët që mbeten shqetësues dhe problematik janë besueshmëria e të dhënave dhe shërbimi ndaj klientit. Kjo shprehet qartë edhe në raportin e KLSH për “Kontrollin e Informacionit të Sistemeve Teknologjike në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve¹⁷”, ku

17 Infrastruktura që hoston sistemin e-Taksave po përballët me sfida të tilla si hapësira të kufizuara, pajisje të vjetruara afër fundit të ciklit të tyre të jetës dhe sisteme operative për të cilat nuk ofrohet më mbështetje, duke çuar në kushte jo optimale të sigurisë. Pavarësisht ekzistencës së dispozitave ligjore në lidhje me infrastrukturën kyçe, Agjencia Kombëtare e Shqërisë së Informacionit dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike nuk e kanë vlerësuar rëndësinë kritike të sistemit të e-Taksave, duke rezultuar në masa të papërshtatshme të sigurisë kibernetike. Auditimi thekson gjithashtu shqetësimet në

theksohet domosdoshmëria e marrjes së masave të menjëhershme të sigurisë për sistemin e-Tax. *Cjatë konsultimeve kemi evidentuar shqetësime lidhur me cilësinë e komunikimit me shkrim për çështje teknike, duke përfshirë edhe vonesat.*

Figura 6. Kënaqësia me shërbimet elektronike



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

lidhje me aksesin në të dhënat nga struktura e TIK-ut të AKSHI-së atashur në DPT, menaxhimin e ndryshimeve të padokumentuara në funksionalitetin e sistemit dhe mungesën e monitorimit të vazhdueshëm të aksesit të përdoruesve, duke krijuar potencialisht dobësi për veprime të paautorizuara përtej juridiksionit të AKSHI-t. Si administratorë e të dhënave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i kërkohet të luajë një rol më ndërveprues në menaxhimin e Teknologjisë së Informacionit, duke siguruar që veprimet e përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm të monitorohen me efektivitet dhe të dhënat e sistemit të shërbejnë si tregues të saktë të aktiviteteve të institucionit.


(6) Bizneset vlerësojnë pozitivisht platformën qendrore të faturave të administratës tatimore (fiskalizimi), duke nxjerrë në pah rëndësinë dhe stimulimin e edukimit fiskal, veçanërisht për NMVM-të, të prezantuar nga ky sistem për tatimpaguesit. Ky aspekt edukativ ka ndikuar disi, edhe pse jo ndjeshëm, në uljen e informalitetit të shfaqur në formën e mosdeklarimit. Megjithatë, theksohet se fiskalizimi ende nuk funksionon me kapacitet të plotë për shkak të çështjeve teknike të vazhdueshme, duke filluar nga shqetësimet e sigurisë deri te sfidat e përputhshmërisë ndërmjet aspekteve teknike dhe ligjore. Problemet specifike të theksuara nga bizneset përfshijnë shembujt dhe skenarët e mëposhtëm: (i) *Elementi më i fundit mbi sigurinë i prezantuar në e-Albania nuk është përfshirë në mënyrë adekuate edhe në platformën Selfcare;* (ii) *Alokimet e pamjaftueshme të përdoruesve për një kompani që çojnë në vështirësi në përdorimin e llogarisë në Selfcare;* (iii) *Pra-nia e opsioneve të shumta të programeve kompjuterike në treg që funksionojnë krahas platformës Selfcare;* (iv) *Mungesa e trajnimit si për ofruesit e programeve kompjuterike ashtu edhe për përdoruesit e sistemit, etj. (Këto çështje i janë përcjellë DPT për veprime të mëtejshme.)*

(7) Vihen re vonesa në kthimin e përgjigjeve nga shërbimi i tatimpaguesve në lidhje me fiskalizimin. Për rrjedhojë, *bizneset kërkojnë ngritjen e një qendre telefonike për adresimin e problemeve në kohë reale kur ato lindin.* Për më tepër, përmes diskuti-


meve sasiore dhe cilësore me bizneset, duket se po shfaqet një “barrë administrative” e re brenda kompanive, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme – *përshtatja ndaj digjitalizimit në mënyrë që këto kompani të mund të përqafojnë dhe përdorin në mënyrë efektive shërbimet online.* Kjo është e lidhur me nivelin e digjitalizimit të brendshëm të kompanive dhe rritjen e njohurive digjitale midis punonjësve të tyre (zotësi teknologjike ose pagesa shtesë për angazhimin e ekspertëve në këtë fushë). Menaxhimi elektronik i dokumenteve, arkivimi, përdorimi i nënshkrimeve elektronike (jo vetëm sporadike), madje edhe përdorimi bazë i platformave online janë sfida për NMVM-të. *1 në 2 kompani deklarojnë se fiskalizimi ka rritur koston e administrimit, sipas të dhënave të sondazhit tonë.*

Figura 7. Fiskalizimi dhe koston shoqëruese të administrimit

A mendoni se shërbimi tatimpagues/procesi i fiskalizimit/etj ka nevojë për ngritjen e një shërbimi elektronik me telefon (call centre)?



A ka ndikuar fiskalizimi në koston e administrimit fiskal? (2024)




Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

(8) Siç u përmend më herët, bizneset e perceptojnë sistemin e fiskalizimit si një ndikim në uljen e informalitetit. Më shumë se 3 në 5 kompani perceptojnë se fiskalizimi ka pasur ndikim në rritjen e formalizimit të ekonomisë. *Kompanitë më të mëdha deklarojnë se përmes sistemit të ri të faturimit tatimor, më shumë biznese të vogla kanë filluar të marrin edukim fiskal, për rrjedhojë kalojnë më shumë tatimpagues informalë në sistemin formal.*

Figura 8. Fiskalizimi dhe Informaliteti

A mendoni që fiskalizimi ka adresuar si duhet zbatimin në praktikë të politikave fiskale dhe masat për formalizimin e ekonomisë? (2024)



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

- (9) *Bizneset e perceptojnë pozitivisht uljen e numrit të kontrolleve tatimore të kryera nga administrata tatimore, duke ia atribuar këtë zbatim të Sistemit të Riskut, i cili u promovua efektivisht që nga viti 2016 në identifikimin e bizneseve me rrezik të lartë që kanë më shumë gjasa t'i nënshtrohen kontrolleve tatimore*¹⁸. Megjithatë, shqetësimet vazhdojnë në lidhje me afatet kohore të këtyre kontrolleve tatimore, si në lidhje me kohëzgjatjen e evidentuar në terren dhe finalizimin e raporteve të kontrollit tatimor dhe dhënien e konkluzioneve, si dhe me metodologjinë dhe konceptet e përdorura për të arritur në përfundime. Disa nga këto çështje që lidhen me kontrollet tatimore pranohen nga vetë DPT. Konkretisht, në raportin vjetor të DPT për vitin 2023¹⁹, si shqetësimet kryesore për kontrollet tatimore janë evidentuar këto çështje:
- Problematika të dala në metodologjinë e kontrollit tek tatimpaguesit*
 - Mospërmbushjet e afateve të kontrollit apo shkeljet ligjore në trajtimin e kontrolleve.*
 - Verifikime/kontrolle për tatimpaguesit proces rindërtimi pa pjesëmarrjen e specialistëve inxhinier ndërtimi.*
 - Analiza e problematikave të konstatuara dhe mangësitë e inspektoreve të kontrollit*
 - Rekomandime të programeve të trajnimit për rritjen e kapaciteteve dhe aftësive të inspektorëve.*
 - Raportimin dhe rakordimin e evidencave.*
 - Afatet e miratimit të raport kontrolleve nga drejtuesit e Drejtorive Rajonale të Tatimit (DRT)*

18 Në takimin në DPT u informuam se Manuali i Menaxhimit të Riskut përditësohet periodikisht me tipologji treguesish që analizohen nga raste konkrete të hasura në praktikë.

19 <https://www.tatime.gov.al/c/8/42/49/strategjia-dhe-raporte>

- h. Menaxhimin e çështjeve në sistemin tatimor.*
- (10) Situata pas periudhës së Covid-19 dhe hapja e tregut shqiptar, e cila është ende në fazat paraprake, është shoqëruar me një rritje të numrit të aplikimeve në DPT për shmangien e taksimit të dyfishtë. Kjo ka sjellë një problematikë të re, e cila gjatë takimeve tona konsultative rezultoi si një çështje sistematike, veçanërisht në 2 vitet e fundit dhe një shembull pasigurie për komunitetin e biznesit, veçanërisht për subjektet tatimpagues të huaj.

KUTIA 1

Marrëveshjet për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë – Trajtimi i Aplikimeve

- » *Nga takimet e Sekretariatit kryesisht me studiot e konsulencës në fushën ligjore dhe të taksave, rezulton se trajtimi dhe zgjidhja e kërkesave për eliminimin nga tatimi i dyfishtë nga DPT është shndërruar në një problematikë tipike me administratën tatimore. Ato lidhen me ndryshimin e një praktike të konsoliduar ndër vite nga DPT për afatin e trajtimit dhe pranimin të kërkesave, listën jo-shteruese të dokumentacionit dhe evidencave të kërkuara (si p.sh.: informacion nga sisteme si TIMS që nuk mund të aksesohen nga tatimpaguesi), dhe burokracinë e tejzgjatuar (mbi 2 dhe 3 vjet) në trajtimin e çështjeve, kërkesave dhe detajeve shtesë të panevojshme mbi vërtetësinë e dokumentacionit (vulë e njomë nga institucionet e huaja), etj.*
- » *Kuadri ligjor bazë aktualisht është i rregulluar me parashikimet e bëra në ligjin dhe të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe Ud-*

ekonomike ndërkombëtare në zhvillim. Pika fillestare duhet të jetë konsultimi paraprak i Udhëzimit dhe zgjidhjes me ekspertët e jashtëm në sektorin privat, të cilët mund të ndajnë praktikën më të mira të provuara në BE.


5.2 INFORMALITETI

A. Pavarësisht përpjekjeve për formalizimin e ekonomisë, veçanërisht në uljen e mosdeklarimeve, punës së padeklaruar dhe mosregjistrimit, bizneset ende ruajnë një perceptim të lartë të informalitetit brenda vendit.

- (1) Sipas të dhënave të anketimit, një në shtatë kompani e percepton ekzistencën e informalitetit në vend, një tendencë që ka vazhduar ndër vite, me përjashtim të vitit 2018 kur më pak biznese perceptonin informalitet në vend (me shumë gjasa për shkak të aksioneve kundër informalitetit që ka ndërmarrë qeveria gjatë viteve 2016-2017).

Figura 9. Perceptimi mbi Informalitetin

Lutem përcaktoni nëse ndesheni me konkurrencë nga aktivitete informale në sektorin ku operoni? **PO**



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

hëzim e Përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”. Ndërkohë nga pikëpamja procedurale, shqyrtimi i kërkesave bëhet në bazë të një udhëzimi të vjetër Nr. 6, datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”. Pavarësisht nga kjo, problematikat duket se nuk lidhen më tepër me kuadrin ligjor, sesa me qasjen dhe argumentimin individual të bërë për trajtimin e kërkesave të biznesit dhe ndoshta me kapacitetet e kufizuara në dispozicion për trajtimin e çështjeve komplekse që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për shmangien e tatimit të dyfishtë ku Republika e Shqipërisë është palë.


» *Kjo u pranua si një problematikë edhe nga vetë administrata tatimore e cila e ka adresuar çështjen si në nivel strukturor, ashtu edhe mbi përgatitjen e një udhëzimi të ri të dedikuar për këto raste.*

» *Duke pasur parasysh frekuencën në rritje të transaksioneve ndërkufitare, veçanërisht në kontekstin e integritetit të Shqipërisë në BE dhe zgjerimit të lidhjeve ekonomike me vendet e tjera (aktualisht palë e 43 Traktateve Ndërkombëtare të ratifikuara për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal), zgjidhja mund të jetë në automatizimin e procedurave. Zgjidhja e miratuar mund të pasqyrojë automatizimin e suksesshëm të procedurave të rimbursimit të TVSH-së dhe mund të thjeshtojë procedurat në lidhje me shmangien e kërkesave për taksim të dyfishtë në përputhje me dinamikat*


Perceptimi mbi informalitetin ndryshon sipas sektorëve dhe madhësisë së kompanisë. Sektorët e bujqësisë dhe tregtisë perceptojnë nivele më të larta informaliteti, ndërsa sektorët e energjisë, ndërtimit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit perceptojnë nivele më të ulëta informaliteti. Kompanitë më të mëdha kanë një perceptim më të ulët të Informalitetit në krahasim me ato më të voglat.

Figura 10. Perceptimi mbi Informalitetin sipas sektorëve dhe madhësisë së kompanisë

Lutem përcaktoni nëse ndesheni me konkurrencë nga aktivitete informale në sektorin ku operoni?



Lutem përcaktoni nëse ndesheni me konkurrencë nga aktivitete informale në sektorin ku operoni? (2024)




Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024


(2) *Evaizoni fiskal konfirmohet si forma kryesore e shfaqjes së informalitetit në vite, e ndjekur nga puna e padeklaruar dhe mosregjistrimi. Periudha e anketimit përkon me periudhën e hyrjes në fuqi të ligjit të ri të të ardhurave, të cilin bizneset e perceptojnë si një faktor që do të kontribuojë në nxitjen e mëtejshme të informalitetit.*

Figura 11. Natyra e Informalitetit


Lutemi vlerësoni natyrën që ka informaliteti në sektorin tuaj: (2024)



Lutemi vlerësoni natyrën që ka informaliteti në sektorin tuaj: (2022)



Lutemi vlerësoni natyrën që ka informaliteti në sektorin tuaj: (2019)



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024


(3) *Sipas perceptimit të biznesit, konkurrenca e pandershme është identifikuar si faktori kryesor që nxit informalitetin, por ky perceptim ka mbizotëruar deri në vitin 2024, ku ajo u zëvendësua nga barra fiskale në nivel qendror.*

Figura 12. Faktorët që nxitin Informalitetin


Për secilin nga faktorët e renditur identifikoni shkallën e influencës në vendimin e një biznesi për të ndërmarrë riskun e një aktiviteti informal? (2024)



Për secilin nga faktorët e renditur identifikoni shkallën e influencës në vendimin e një biznesi për të ndërmarrë riskun e një aktiviteti informal? (2022)



Renditja sipas rëndësisë mbi Informalitetin (2019)




Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

Bizneset shprehin shqetësimin se ligji i të ardhurave i miratuar së fundmi do të rrisë potencialisht informalitetin, kryesisht për shkak të barrës së konsiderueshme tatimore të vendosur mbi bizneset e prekura. Sipas këtij ligji, normat tatimore për disa NMVM të caktuara rriten nga 0% në 18% dhe 23%. Konsultimet e drejtpërdrejta me kompanitë kanë nënvizuar ndikimin e legjislacionit fiskal, duke përfshirë vendosjen e përjashtimeve ose normave tatimore 0%, në nxitjen e mungesës së ndërgjegjësimit për respektimin e taksimit tek bizneset. Rrjedhimisht, rifutja e taksimit për disa biznese të vogla, duke lënë të tjera të pataksuara, perceptohet të intensifikojë informalitetin në vend.

Figura 13. Informaliteti dhe Ligji i ri mbi të ardhurat

Si mendoni se do të ndikojë në sektorin tuaj zbatimi i ligjit të ri mbi të ardhurat në shkallën e informalitetit?




Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

(4) *Ndërkohë, diskriminimi pozitiv në tatimin e aktivitetit të biznesit mund të ndihmojë në uljen e informalitetit. I pyetur për ndikimin e uljes së TVSH-së në uljen e informalitetit në sektorin e turizmit, sektori i turizmit pohon këtë korrelacion. 2 në 5 kompani që operojnë në këtë sektor perceptojnë një rënie të informalitetit si rezultat i kësaj politike fiskale.*

Figura 14. Ulja e TVSH-së në turizëm dhe Impakti në Informalitet

Në fushën e turizmit ku disa shërbime kanë përfituar ulje të TVSH-së në 6%, mendoni se kjo politikë ka sjellë uljen e informalitetit në këtë sektor? (2024)



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

(5) Rritja e standardeve si oportunitet për adresimin e informalitetit sektorial

Informaliteti është një nga pengesat kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve formale dhe rrjedhimisht për ekonominë e vendit në përgjithësi. Faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në mjedisin e biznesit lidhen me ndryshimet e shpeshta në legjislacion, shpeshherë të pakuptueshme për bizneset kryesisht të vogla dhe tendencat në rritje të normave të interesit që e bëjnë kreditimin më të shtrenjtë. Por, ndërsa forcimi i luftës ndaj informalitetit është një objektiv strategjik i administratës tatimore e cila ka përmirësuar aktivitetet në mënyrë periodike (zbatimin e sistemit të menaxhimit të riskut, kryerjen e verifikimeve dhe kontrolleve mbi baza analize risku, si dhe implementimin e fiskalizimit), reduktimi i informalitetit në sektorë të caktuar, mbetet ende sfidë që kërkon edhe përfshirjen e institucioneve të tjera.


KUTIA 2

Turizmi, transporti dhe sektori i pjesëve të këmbimit dhe riparimit të mjeteve


- » Rastet e informalitetit në sektorë të veçantë, si ai i turizmit (struktura akomoduese të peregjistruara, të pastandardizuara, të palicencuara dhe jashtë radarit të institucioneve të administratës fiskale në nivel qendror dhe vendor), janë diskutuar më herët në KI.20 Për këto raste është rekomanduar që zgjidhja e problemit të mos shihet vetëm në rolin e administratës tatimore për të identifikuar informalitetin, por edhe në rolin e politikave rregullatore fiskale dhe sektoriale, duke përfshirë këtu forcat e tregut që i shtojnë bizneset drejt rritjes së standardeve, rritjes së konkurrencës dhe, rrjedhimisht, formalizimi.
- » Ndryshimet më të fundit të propozuara në ligjin 93/2015 “Për turizmin”, (i ndryshuar) me fokus rritjen e cilësisë së shërbimeve në sektorin e turizmit, janë nxitur nga rritja e kërkesës për shërbime turistike për shkak të rritjes së shpejtë dhe progresive të sektorit. në vend. Formalizimi i sektorit dhe rrjedhimisht i sektorëve të tjerë të lidhur me të çon në rritjen e cilësisë së ofertës dhe standardeve të zbatuara.
- » Një qasje e tillë duhet shtrirë edhe në sektorë të tjerë sikurse transporti dhe ai i pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të mirëmbajtjes së automjeteve të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe kërkojnë

Figura 15. Produktiviteti i punës

Duke përkufizuar produktivitetin e punës si vlerën (monetare) që merr kompania nga një ditë pune e punonjësve tuaj, si do ta vlerësonit ju produktivitetin e tyre në raport me atë të kompanive të tjera në sektorin ku operoni? (2024)



Duke përkufizuar produktivitetin e punës si vlerën (monetare) që merr kompania nga një ditë pune e punonjësve tuaj, si do ta vlerësonit ju produktivitetin e tyre në raport me atë të kompanive të huaja, me të cilat bashkëpunoni? (2024)



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

një qasje të integruar rregullatore në të gjitha hallkat. Ndërsa importi i pjesëve të këmbimit konsiderohet në një masë të madhe i rregulluar dhe i formalizuar, shërbimet e mirëmbajtjes që kryhen për përdoruesit e automjeteve konsiderohen ende të parregulluar si në drejtim të standardeve, sigurisë dhe cilësisë ashtu edhe në drejtim të pajtueshmërisë tati-more.

5.3 PRODUKTIVITETI, INOVACIONI DHE KONKURRUESHMËRIA


- A. Kompanitë në vend perceptojnë nivele të ngjashme produktiviteti krahasuar me konkurrentët e tyre vendas. Megjithatë, ata kanë një pikëpamje pesimiste për nivelin e tyre të produktivitetit kur krahasohen me konkurrentët që operojnë në tregjet rajonale dhe më gjerë. Kjo dobësi potencialisht pengon aftësinë e kompanive shqiptare për të konkurruar në mënyrë efektive në tregjet e përbashkëta rajonale dhe më të gjera.

- (1) Brenda tregut kombëtar, një në dy kompani raporton se ka një produktivitet të punës të ngjashëm me konkurrentin e saj, ndërsa një në dy kompani raporton se ka produktivitet më të ulët në krahasim me konkurrentët e huaj.
- (2) Perceptimi se produktiviteti krahasuar me konkurrentët vendas është i ngjashëm nuk vlen për të gjithë sektorët. Janë vërejtur tre modele të

diversitetit të produktivitetit të punës brenda sektorit. Ka sektorë ku kompanitë janë lidere në produktivitet me produktivitet më të lartë se pjesa tjetër e kompanive. Sektorë të tillë janë energjia dhe, në një farë mase, sektori i TIK-ut. Sektorët tradicionalë si bujqësia, tregtia, ndërtimi dhe shërbimi raportojnë se nuk perceptojnë shpërndarje të produktivitetit në nivel sektorial, duke u përgjigjur se produktiviteti midis kompanive të ndryshme është i të njëjtit nivel. Firmat që operojnë në treg për më shumë se 10 vjet si dhe kompanitë me punonjës mbi 250, raportojnë se produktiviteti i tyre është më i lartë se ai i konkurrentëve. NMVM-të në përgjithësi raportojnë se e perceptojnë produktivitetin e tyre të ngjashëm me atë të konkurrentëve në nivel lokal.

Bazuar në të dhënat sektoriale të Anketës kombëtare për ndërmarrjet ne përdorëm vlerën e shtuar sektoriale dhe numrin e punonjësve në fund të vitit për të vlerësuar produktivitetin e punës si vlerën e shtuar të krijuar për punonjës. Vlera mesatare e shtuar e krijuar për punonjës për periudhën 2019-2022 është 11.888 Euro/vit. Sektorët tradicionalë dhe sektori publik kanë produktivitet pothuajse të ngjashëm me mesataren kombëtare. Sektorë të tillë si ndërtimi, industria përpunuese, transporti, tregtia, akomodimi dhe industria ushqimore (duke përfshirë turizmin) kanë një vlerë të shtuar për punonjës rreth mesatares kombëtare. Sektorët me produktivitetin më të lartë të punës (i matur si vlerë e shtuar për punonjës) janë industritë nxjerrëse, energjia, shërbimet profesionale, sektori i pasurive të paluajtshme, të ndjekur nga sektori i TIK-ut.

Figura 16. Produktiviteti i punës sipas sektorëve, krahasuar me kompani vendase



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024


Dinamika e produktivitetit të punës, e matur me normën mesatare të rritjes së vlerës së shtuar të krijuar për punonjës nga viti 2019 në 2022, tregon një rritje të përgjithshme prej 11% në të gjithë sektorët (referojuni aneksit V). Megjithatë, *disa sektorë me nivele tradicionalisht të larta të produktivitetit kanë pësuar një ngadalësim të rritjes së produktivitetit*. Këto përfshijnë sektorët e energjisë, TIK-ut dhe ndërtimit. Në të kundërt, *sektorë të tillë si akomodimi dhe shërbimet ushqimore (turizmi), industritë përpunuese dhe nxjerrëse, si dhe rekreacioni dhe argëtimi kanë treguar rritje të ndjeshme në produktivitet. Sektori i*

shëndetësisë po kalon gjithashtu një rritje të produktivitetit, së bashku me sektorët e administratës publike, mbrojtjes dhe mbrojtjes sociale.

Në përputhje me perceptimin e biznesit mbi produktivitetin, industritë (të tilla si energjia dhe ndërtimi) ku firmat raportojnë se kanë produktivitet të lartë janë në kufirin optimal të prodhimit, ndërsa sektorët tradicionalë (turizmi, industria) raportojnë hapësirë për përmirësimin e produktivitetit të ngjashëm me distancën nga prodhim optimal. Mosefikasiteti i lartë në sektorin e tregtisë, argëtimit dhe rekreacionit ose i pasurive të palua-

Figura 17. Produktiviteti mesatar per punonjës (në Euro, vjetore 2019-2022)

Produktiviteti mesatar i punës për punonjës (në euro, vjetor 2019-2022)




Burimi: Anketa e Ndërmarrjes dhe Përllogaritje të Sekretariatit

jtshme tregon një devijim që është më shumë një shpërndarje e gabuar e burimeve sesa një joefikasitet sektorial (më shumë burime shpërndahen në ata sektorë që kërkon kufiri optimal i prodhimit).²¹

duktiviteti i punës, i matur si raport i prodhimit total me numrin e njerëzve të punësuar, është gjysma e atij të ekonomive të tjera në rajon (p.sh. Serbia dhe Mali i Zi) dhe edhe më i ulët nëse krahasohet me Bullgarinë ose Kroacinë.

Figura 18. Produktiviteti i punës sipas sektorëve, krahasuar me kompani të huaja





Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

(3) Në përgjithësi, perceptimi se kompanitë kanë produktivitet më të ulët se kompanitë e huaja me të cilat konkurrojnë është dominues edhe në nivel sektorial. Kompanitë që operojnë në sektorët e ndërtimit, tregtisë, TIK-ut dhe turizmit perceptojnë një produktivitet që është në linjë dhe si konkurrentët e tyre të huaj. Kompanitë që operojnë në bujqësi, energji, shërbime dhe industri raportojnë se kanë një disavantazh në krahasim me konkurrentët e tyre të huaj për sa i përket produktivitetit të ulët të punës.

Studime të ndryshme konfirmojnë gjithashtu se produktiviteti i punës është i ulët krahasuar me atë të ekonomive rajonale të Shqipërisë. Pro-



Figura 19. Produktiviteti i punës krahasuar me ekonomitë rajonale



Burimi: Produktiviteti në BP dhe Xhepa and Liperi (2022)

(4) Bizneset raportojnë se rritja e aftësive përmes trajnimit në punë do të përmirësonte produktivitetin e punës dhe 24% e bizneseve raportojnë se kanë nevojë për një trajnim të tillë për të përmirësuar produktivitetin. 1 në 5 biznese mendojnë se rritja e produktivitetit do të rezultonte nga rritja e pagave. 46% e kompanive të intervistuarat janë përgjigjur tashmë presionit për të rritur pagat që rezultoi nga rritja e pagave në sektorin publik.


Figura 20. Masat për nxitjen e rritjes së produktivitetit në punë



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

(5) Rritja e produktivitetit duket të jetë një prioritet për shumicën e kompanive, me shtatë nga dhjetë që deklarojnë synimin e tyre për të zbatuar masa për rritjen e produktivitetit.

Figura 21. Rritja e produktivitetit në punë



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024


21 Për më shumë detaje referoju Shtojcës V.

- (6) *Duke qenë se përmirësimet e produktivitetit nënkuptojnë masa që kërkojnë financim shitesë, kompanitë (32% e kompanive të anketuara) kërkojnë më pak barrë fiskale për të qenë në gjendje të financojnë ndërhyrje për përmirësimin e produktivitetit.* Politika tatimore dhe administrata tatimore janë faktorë të rëndësishëm në adresimin e sfidave të produktivitetit. Sistemet tatimore mund të rrisin produktivitetin duke reduktuar shtrembërimet e shpërndarjes së burimeve. Politikat fiskale gjithashtu mund të rrisin fondet e disponueshme për të mbështetur masat për rritjen e produktivitetit.
- (7) *Kompanitë e njohin rëndësinë e inovacionit në rritjen e produktivitetit dhe konkurrencës së tyre në tregje. Megjithatë, vetëm një numër i vogël i kompanive ndajnë fonde në mënyrë specifike për kërkim dhe zhvillim dhe trajnimin e punonjësve.*
- (8) *Kompanive iu kërkua të identifikonin angazhimin e tyre ndaj inovacionit si pjesë e strategjisë së tyre të kompanisë. 54% e kompanive raportuan se ishin shumë të përkush-*

tuara/të shqetësuara për inovacionin, 34% raportuan se i jepnin pak vëmendje/përkushtim praktikave inovative të biznesit dhe 21% raportuan se nuk kishin fare interes. Pjesa e kompanive që kujdesen për inovacionin ka rënë ndjeshëm nëse krahasohet me të dhënat e vitit 2021.


(9) *Investimet në K&ZH dhe trajnimin e punonjësve janë ndër ndërhyrjet më të rëndësishme në përmirësimin e produktivitetit.* Kompanive iu kërkua të identifikonin nëse investojnë në Kërkim dhe Zhvillim dhe nëse kanë një buxhet të dedikuar për këtë qëllim. Vetëm 6% e kompanive kanë konfirmuar se kanë një buxhet të dedikuar për K&ZH. Në vitin 2024, prirja e kompanive që investojnë në K&ZH ka rënë me 8% (14% e kompanive kanë konfirmuar të investojnë në K&ZH në 2021). 54% e kompanive kanë deklaruar se kanë një buxhet të posaçëm për K&Zh, ndërsa 40% raportojnë se nuk kanë fare buxhet. I njëjti trend duket se mbizotëron edhe sa i përket ndarjes së fondeve të dedikuara për trajnimin e stafit.

Figura 22. Masat për rritje të Produktivitetit



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024


Figura 23. Vëmendja ndaj inovacionit



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

Figura 24. Dedikimi ndaj investimeve në K&ZH

A ka kompania juaj një fond të dedikuar për Kërkim dhe Zhvillim?




Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024


- (10) *Duke pasur parasysh faktin se produktiviteti i punës është i lidhur ngushtë me teknologjinë, kompanive iu kërkua të identifikonin nëse ka raste kur puna e tyre është ndërprerë për shkak të problemeve teknologjike. 72% e kompanive raportuan se puna e tyre u ndërpre për shkak të problemeve me teknologjinë e prodhimit dhe për 94% të të anketuarve procesi i punës u ndal për shkak të problemeve teknologjike që zgjasin nga 30 deri në 60 minuta.*

Figura 25. Teknologjia dhe Produktiviteti

Nëse po, ju lutem specifikoni në terma kohorë, në mënyrë të përafërt, sa minuta janë këto ndalesa? (2024)



A ju ndodh gjatë një dite pune, të pezulloni punën për shkak të një avarie (p.sh. ndërprerje elektriciteti, sistemi nuk punon, po prisni një proces tjetër pune të përfundojë, etj.)? (2024)



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

Sekretariati përdori të dhënat nga Anketa Kombëtare për Ndërmarrjet dhe shqyrtoi ndryshimin e raportit të vlerës së shtuar ndaj investimit kundrejt vlerës së shtuar ndaj punës. Ekziston një korrelacion pozitiv midis produktivitetit të investimeve dhe produktivitetit të punës (koeficienti i korrelacionit 0.37), duke treguar se ndikimi i teknologjisë në përcaktimin e produktivitetit të punës është i rëndësishëm.

Në nivel kombëtar, pjesa e kostos së punës ndaj vlerës së shtuar është 42%, dhe kapitali (investimet) është 31%. Sektorët në të cilët pjesa e vlerës së shtuar nga investimet është më e lartë se ajo e punës janë pasuritë e paluajtshme, energjia, uji dhe menaxhimi i mbetjeve. Për sektorë të tillë si akomodimi dhe ushqimi (turizmi), industritë nxjerrëse, industria përpunuese, TIK, tregtia dhe transporti, pjesa e investimeve dhe e punës në vlerën e shtuar është pothuajse proporcionale. Puna dhe kapitali kombinohen në krijimin e vlerës në një raport një me një, duke

shkaktuar kushtëzimin e lartë të produktivitetit. Puna e pakualifikuar ose joproductive do të minonte produktivitetin e kapitalit, dhe në mënyrë të ngjashme, teknologjia joproductive e prodhimit do të bënte që produktiviteti i punës të ishte nën-optimal.

- (11) Konkurrueshmëria e kompanive shqiptare në tregjet ndërkombëtare ka një rëndësi të madhe, veçanërisht në kontekstin e aderimit në tregjet rajonale dhe evropiane. Rrjedhimisht, rritja e produktivitetit

dhe promovimi i inovacionit brenda aktiviteteve të biznesit do të sillte përfitimet e nevojshme për vendin.

- (12) Në vitin 2024, disponueshmëria e fuqisë punëtore, një faktor i lidhur drejtpërdrejt me aktivitetin e biznesit, merr përparësi ndaj të gjithë elementëve të tjerë që kanë të bëjnë me konkurrencën e kompanive shqiptare. Kjo është në kontrast me dy vite më parë kur konsiderohej faktori i katërt në renditje.

Figura 26. Produktiviteti i punës kundrejt produktivitetit të investimeve (2019-2022)






Figura 27. Pengesat për konkurrencën.

Nga faktorët e mëposhtëm të lidhur direkt me kompaninë tuaj, cilët mund të konsiderohen 3 pengesat kryesore në integrim në zinxhirët ndërkombëtar të vlerës? (2022)



Nga faktorët e mëposhtëm, të lidhur direkt me kompaninë tuaj, cilët mund të konsiderohen 3 pengesat kryesore në integrim në zinxhirët ndërkombëtar të vlerës? (2024)




Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI

- (13) Në vitin 2024, informaliteti, politikat tregtare dhe aksesit në financë konsiderohen si pengesat kryesore për integrimin. Në mënyrë të ngjashme, informaliteti u identifikua gjithashtu si pengesa kryesore në vitin 2022, e ndjekur nga aksesit në financë në vendin e dytë dhe politikat tregtare në vendin e tretë.

Figura 28. Pengesat për konkurrencën

Nga faktorët e mëposhtëm të lidhur indirekt me kompaninë tuaj, cilët mund të konsiderohen 3 pengesa kryesore për integrim në zinxhirët ndërkombëtar të vlerës?



Burimi: Anketa të Sekretariatit të KI

5.4 BARRA RREGULLATORE DHE KLIMA E BIZNESIT


A. BARRA RREGULLATORE

- (1) Sipas perceptimit të biznesit, barra rregullatore është rritur gjatë tre viteve të fundit, me gati 3 në 5 kompani që konfirmojnë këtë prirje. Sektorët e TIK-ut, të ndërtimit dhe të shërbimeve perceptojnë një rritje të barrës rregullatore gjatë tre viteve të fundit. Në të kundërt, sektorët e Energjisë, Indus-

trisë dhe Bujqësisë perceptojnë një rritje më të vogël të barrës rregullatore. 57% e shoqërive me xhiro deri në 14 milionë lekë perceptojnë rritje të barrës së përgjithshme rregullatore, ndërsa 48% e shoqërive me xhiro vjetore mbi 14 milionë lekë raportojnë të njëjtën gjë.

Figura 29. Barra Rregullatore

Si ka ndryshuar barra e përgjithshme rregullatore mbi biznesin tuaj gjatë tre viteve të fundit? (2024)




Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024


- (2) 64% e kompanive janë të pasigurt për ekzistencën e nismave që synojnë uljen e kostos së përputhshmërisë me kuadrin rregullator. Megjithatë, sektorët e turizmit, shërbimeve dhe bujqësisë shfaqin ndërgjegjësim më të madh për iniciativa të tilla rregullatore. Ndër kompanitë që deklarojnë ndërgjegjësim për masat që synojnë uljen e kostove të përputhshmërisë me kuadrin rregullator, gati 3 në 5 raportojnë se këto stimuj kanë rezultuar në kursim kohe dhe parash në operacionet e tyre.

Figura 30. Iniciativa për uljen e barrës rregullatore

A jeni në dijeni nëse gjatë tre viteve të fundit në nivelin qendror dhe lokal janë zbatuar nisma për të ulur koston e pajtueshmërisë me kuadrin rregullator për biznesin? (2024)



Ju lutemi specifikoni nëse iniciativat kanë ndihmuar për të kursyer kohë dhe/ose para të biznesit tuaj? (2024)




Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

- (3) Legjislacioni tatimor vlerësohet si fusha me ngarkesën më të madhe administrative për kompanitë, e ndjekur nga inspektimet dhe shpeshtësia e inspektimeve. Perceptimet ndryshojnë kur merret parasysh një qasje sektoriale. Për shembull, sektori i ndërtimit i percepton inspektimet, legjislacioni tatimor dhe prokurimet publike si barrën më të madhe administrative. Sektori i tregtisë identifikon leg-

jislacionin e konkurrencës, prokurimin publik dhe doganat tregtare si burimet kryesore të barrës administrative. Industria, veçanërisht përpunimi, përjeton ngarkesa më të rënda administrative nga legjislacioni mjedisor, tatimor dhe i prokurimit publik.

Figura 31. Fushat që ndikojnë më shumë në kostot administrative

Cila nga fushat e mëposhtme shkakton një barrë administrative për ndërmarrjen tuaj, e matur në orë pune dhe/ose kostove të shkaktuara? (2024)



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

KUTIA 3

Barra administrative dhe perceptimet e biznesit

Gjatë viteve të fundit, dhe veçanërisht në vitin 2016, Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në përmirësimin e legjislacionit tatimor dhe klimës së biznesit. Gjithashtu, thjeshtimi i vazhdueshëm i procedurave tatimore dhe modernizimi i sistemit të taksave të TI-së, duke kulmuar me ofrimin e shumë shërbimeve online nga autoritetet publike nëpërmjet portalit e-Albania, ndikuan ndjeshëm në uljen e barrës administrative. Megjithatë, kjo ndryshoi me hyrjen në fuqi të reformës së fiskalizimit, e cila rriti në afat të shkurtër


aplikimesh ende të papërgatitura nga pikëpamja teknike, perceptohen në rritjen e mëtejshme të barrës administrative për bizneset.

B. KLIMA E BIZNESIT

- (1) Të anketuarit e konsiderojnë regjistrimin e biznesit dhe procedurat e licencimit/autorizimit elementët më të favorshëm për të bërë biznes në Shqipëri. Megjithatë, procedurat dhe kostot e huamarrjes, barrat fiskale dhe inspektimet janë ndër elementët më pak të favorshëm.

Figura 32. Klima e Biznesit

Si do ta vlerësonit ju klimën e të bërit biznes në sektorin ku ju operoni, bazuar në elementët e mëposhtëm? (2024)



Burimi: Anketë e Sekretariatit të KI, 2024

Mendojmë se perceptimi i biznesit për faktorët favorizues bazohet në qëndrueshmërinë e legjislacionit për regjistrimin e biznesit, në procedurat e zbatuara nga QKB dhe strukturimin e tyre, si dhe në futjen e gjerë të shërbimeve

kërkesën e pajtueshmërisë për bizneset. Bizneseve iu shtuan shtatë hapa/procedura me kosto administrative dhe financiare:

- Regjistrimi i tatimpaguesve si lëshues të faturave
- Regjistrimi i vendit të veprimtarisë
- Regjistrimi i pajisjeve elektronike të faturimit
- Regjistrimi i operatorëve
- Zgjidhjet e pajisjeve dhe softuerëve për zbatimin e procedurës së fiskalizimit.
- Certifikatë elektronike
- Zbatimi i procedurës së fiskalizimit të faturave

Fiskalizimi në Shqipëri përfshinte të gjitha kategoritë e bizneseve, si dhe transakSIONET, pavarësisht nga natyra apo lloji i bizneseve të përfshira. Prandaj, shtrirja e zgjeruar e zbatimit përfshinte marrëdhëniet biznes me biznes, biznes me konsumator dhe marrëdhënie biznesi me publikun. Zbatimi në intervale të ngushta kohore, pa u shoqëruar me mbështetje teknike, pa manual apo koment, krijoi probleme për shumë tatimpagues. Në shumë raste nuk janë dhënë në kohë sqarimet teknike.

Pajtueshmëria me kërkesat e fiskalizimit, tashmë që problemet teknike janë zbehur, nuk është problem për bizneset dhe as barrë administrative. Megjithatë, procedurat dhe kostot që lidhen me pajisjet me certifikatë të kualifikuar për nënshkrim elektronik janë raportuar si të rënda, veçanërisht për bizneset e vogla. Krahas sa më sipër, paqartësitë që janë shoqëruar me hyrjen në fuqi të ligjit 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili parashikon një sërë procedurash dhe

elektronike. Përdorimi i shërbimeve elektronike u përhap kur u vendos që institucionet të ishin përgjegjëse për marrjen dhe shkëmbimin mes tyre të dokumentacionit shoqërues për aplikimet e bëra nga qytetarët/bizneset nëpërmjet Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE). Kjo zhvendosi barrën administrative (numrin e procedurave, afatet e përpunimit, etj.) të dokumentacionit nga biznesi tek institucionet, si në rastin e aplikimeve për regjistrim biznesi në seksionin e dedikuar në QKB në platformën e-Albania. Procedurat online për regjistrimin e biznesit janë zakonisht të shpejta. Gjatë vitit 2023 janë evidentuar raste të vonesave për shkak të detyrimit të bizneseve për t'u pajisur me certifikata të kualifikuara për nënshkrimet elektronike nga AKSHI dhe vonesa nga ky i fundit në dorëzimin e tyre.

Ndërkohë që regjistrimi në regjistrin tregtar është tashmë një procedurë e konsoliduar, çregjistrimi si subjekt/tatimpagues është një problem që raportohet prej vitesh nga bizneset. Ndërkohë që bizneset janë çregjistruar në regjistrin tregtar të QKB-së sipas afateve të përcaktuara qartë në ligj, administrata tatimore i konsideron ende tatimpagues edhe pas skadimit të këtyre afateve, duke i kërkuar shpesh QKB-së me shkresë zyrtare të mos çregjistrojë subjektin. Pra, praktikisht ka raste kur subjektet ndonëse janë çregjistruar në regjistrin tregtar, sërish rezultojnë tatimpagues në regjistrat e administratës tatimore. Janë shumë të qarta përmirësimet ligjore në kuadër të treguesit të *Doing Business*²² të bëra gjatë vitit 2018 në ligjin 9920/2008 “Për procedurat tatimore”. *Data e çregjistrimit të*

tatimpaguesit në administratën tatimore është data e çregjistrimit në QKB ose në gjykatë për të gjitha subjektet që janë çregjistruar pranë tyre. Kjo do të thotë se pas skadimit të afateve të përcaktuara prej 10 ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës dhe 30 ditë pune për kontrollin tatimor sipas analizës së riskut nëse subjekti nuk ka detyrime aktuale duhet të çregjistrohet si subjekt/tatimpagues. Zgjatja e afateve, edhe pse për arsye objektive nga administrata tatimore, si ato që lidhen me verifikimin e detyrimeve të subjektit/tatimpaguesit dhe procedurat e kontrollit tatimor, është në kundërshtim me ligjin. *Gjatë konsultimeve me institucionet përkatëse, u konfirmua se QKB dhe DPT janë aktualisht në hapat e fundit të zhvillimit të protokollit teknik për verifikimin në kohë reale të detyrimeve të tatimpaguesve, detyrim i cili është parashikuar që prej vitit 2018 në procedurat tatimore.*

(2) Lidhur me inspektimet në përgjithësi (kontrollin tatimor), komuniteti i biznesit ka një opinion jo pozitiv për objektivat reale të inspektimeve. Kjo është vërtetuar nga Anketa dhe nga takimet e disa bizneseve. Numri i inspektimeve dhe shpeshtësia e tyre, së bashku me numrin e inspektorateve, konsiderohet i tepërt, ndërkohë që bizneset kanë pretendime për kapacitetet teknike të inspektorateve (nuk printojnë aktet administrative dhe nuk ofrojnë transparencë). Reforma e derregullimit me fokus riorganizimin e procedurave të thjeshta administrative dhe reformat e inspektimit që synojnë reduktimin e numrit të inspektorateve dhe strukturimin metodologjik të tyre, kanë qenë objekt analize në KI në mbledhjet e mëparshme. Më konkretisht, në mbledhjen e KI-së XV

(2019), u evidentua se: *“...inspektoriatet janë një pjesë e rëndësishme e administratës publike me të cilën ndërveprojnë bizneset. Ky konfrontim ndikon edhe në perceptimin e biznesit për rolin e administratës si rregullator tregu. Edhe pse ka dinamika pozitive në aspektin formal të reformimit të inspektimeve, në aspektin e përmbajtjes, ka ende vend për përmirësim në shmangien e mbivendosjeve të pushteteve dhe funksioneve ndërmjet inspektorateve të ndryshme dhe forcimin e koordinimit ndërinstitutional Rishikimi*

i legjislacionit sektorial dhe koherenca në shpërndarjen e pushteteve janë faktorë që ende pengojnë optimizimin e efikasitetit të reformës. Në këtë fazë ku ka mbërritur zbatimi i reformës së inspektimit, si pjesë e asaj derregullatore, ndoshta një ringjallje e angazhimit politik dhe dokumenteve strategjike të reforma kërkohej duke bërë publik modelin dhe planin e masave apo aktiviteteve në vazhdim.” Duket se me të gjitha përmirësimet e bëra, ky konstatim është ende i vlefshëm edhe pas 5 vitesh.

REKOMANDIME

Në lidhje me sa më sipër evidentohen dinamika pozitive në komunikim me administratën tatimore, kryesisht si rezultat i aksesit më të lehtë elektronik tatimor, shërbimin më të mirë të klientit në lidhje me fiskalizimin, ndikimin e fiskalizimit dhe uljen e TVSH-së në turizëm në formalizimi i ekonomisë, apo uljen e kontrolleve. Por, kërkohen ndërhyrje të mirëmenduara dhe të matura për të trajtuar çështjet që lidhen me sigurinë e të dhënave, formalizimin (bujqësisë, tregtisë dhe shërbimeve), apo kostot e papritura për NVM-të lidhur me fiskalizimin, apo ndryshimet e shpeshta fiskale. Ndërkohë përsa i përket konkurrenshëmisë në nivel firme, sipërmarrësit vendas mbështesin inovacionin, por në një pjesë të madhe, nuk shpërndajnë burime ose fonde për Kërkim dhe Zhvillim. Ata ende besojnë se janë konkurrues në tregun vendas, ndërkohë që rritja e pagave në sektorin privat nuk erdhi për shkak të rritjes së produktivitetit të ndërmarrjeve tyre, por u stimulua nga iniciativa në sektorin publik. Rekomandimet e mëposhtme synojnë të adresojnë disa nga problematikat e evidentuara më lartë duke u fokusuar tek aspekte të ndërveprimit fiskal në kontekstin e sfidave të integritetit rajon dhe më gjerë i ekonomisë shqiptare, kryesisht duke mbështetur rritjen e produktivitetit të firmës dhe integritetin e inovacionit në të gjithë sektorët e ekonomisë.

REKOMANDIM 1.

Miratimi i Strategjisë për mbledhjen e të ardhurave si një dokument gjithëpërfshirës për të gjithë aktorët në sektorin publik dhe privat. Strategjia duhet t'i nënshtrohet konsultimit dhe diskutimit paraprak me publikun. Dokumenti duhet të evidentojë qartë qëllimet,

objektivat dhe ndërhyrjet afatmesme për të lehtësuar monitorimin e saj dhe llogaridhënien e institucioneve mbi përdorimin e parave të taksapaguesve. Strategjia nuk duhet të synojë vetëm mbledhjen e të ardhurave, por edhe rritjen e produktivitetit dhe konkurrenshëmisë nëpërmjet administrimit më të mirë tatimor

dhe shpërndarjes së drejtë të barrës tatimore. Strategjia duhet të harmonizojë objektivat me strategjitë sektoriale, Programin e Reformave Ekonomike 2024 – 2026 dhe Planit të Rritjes.

REKOMANDIM 2.

Për të stimuluar inovacionin e biznesit duke li-ruar fonde në nivel firme dhe për të nxitur investimet kapitale/teknologjike, **duhen ndërmarrë analiza specifike duke u fokusuar në: (a) amortizimin e përshpejtuar, (b) amortizimin shtesë, (c) njohja si shpenzime të zbritshme të sponsorizimeve dhe donacioneve për K&ZH.**²³

REKOMANDIM 3.

Koherencë e stabilitetit fiskal dhe konsolidim i procedurave tatimore përmes një ligji të ri. Ligji i ri duhet të unifikojë të gjitha praktikatat e procedurave tatimore të parashikuara aktualisht nga disa ligje, akte nënligjore dhe rregullore të zbatueshme në nivel qendror dhe lokal. Miratimi i ligjit të ri duhet të synojë miratimin e praktikave më të mira në lidhje me organizimin e aktiviteteve të administratës tatimore siç parashikohet nga OECD dhe duhet të shoqërohet me një Udhëzues të detajuar që parashikon vendime të qarta tatimore, të zbatueshme drejtpërdrejt për skenarët e biznesit. Pa paragjykuar opsionet në dispozicion të ligjvënësve, ligji i ri duhet të jetë rezultat i një marrëveshjeje politike gjithëpërfshirëse dhe në shkallë të gjerë, dhe mundësisht në nivel kodi (si p.sh. Kodi Doganor).

²³ Rishikimi i fitimit të tatueshëm, nuk duhet të konsiderohet si një përjashtim, por si një nxitje e drejtpërdrejtë, e monitoruar periodikisht nga administrata tatimore mbi impaktin e gjeneruar (MEKI, MF). Objektivi kryesor i rishikimit të fitimit të tatueshëm është përmirësimi i kushteve financiare për nxitjen e investimeve të brendshme, nxitja e metodave inovative produktive, iniciativave kërkimore dhe zhvillimore teknologjike.

REKOMANDIM 4.

Miratimi i një udhëzimi të ri për marrëveshjet dypalëshe për shmangien e taksimit të dyfishtë përmes automatizimit dhe procedurave elektronike të ndjekura nga bizneset dhe administrata tatimore (si p.sh. sistemi i rimbursimit të TVSH-së). Zgjidhja e parashikuar nga udhëzimi nuk duhet domosdoshmërisht të bazohet në një procedurë të mirëfilltë, por t'i referohet e të ndjekë modele të vendeve të BE-së dhe të përditësojë marrëveshjet bazuar në formatet e reja të dokumenteve të lëshuara nga Departamentet Evropiane të Taksave, si për shembull të njihen Certifikatat e Rezidencës të lëshuara në formë elektronike, pa nënshkrime origjinale dhe vula të njoma. Kjo duhet zbatuar me rigozitet përmes një ekipi të përkushtuar ekspertësh në nivel DPT.

REKOMANDIM 5.

Duke pasur parasysh ndërveprimin ndërmjet politikës fiskale, inovacionit dhe produktivitetit, rekomandohet që produktiviteti të jetë në themel të hartimit të politikës fiskale dhe mbështetje direkte për Kërkim&Zhvillim/Novacion. Për më tepër, duhen ndërmarrë analiza të thelluara sektoriale që do të orientojnë ndërhyrjet rregullatore dhe të politikave të nevojshme për të korrigjuar keq shpërndarjen e burimeve dhe jo efikasitetin në nivel sektorial, me fokus të veçantë NVM-të. Rekomandojmë që të krijohen të paktën tre grupe pune ndërministrorë me mandat për të kryer analiza sektoriale për produktivitetin, të paktën për sektorin e turizmit, bujqësisë dhe menaxhimit të energjisë dhe mbetjeve. Këto analiza mund të çojnë në koordinimin e politikave për inovacionin, K&ZH, masat fiskale dhe rritjen e bazuar në produktivitetin ekonomik. Analizat e

ICC tregojnë se produktiviteti ekonomik mund të përmirësohet me 24 %.

REKOMANDIM 6.

Sektorët me hapësirë për rritjen e produktivitetit nëpërmjet produktivitetit të punës janë energjia, menaxhimi i ujit dhe mbetjeve, ndërtimi dhe pasuritë e paluajtshme. Ne rekomandojmë që këta sektorë të vihen nën fokusin e strategjisë së inovacionit duke nxitur më shumë AI/digjitalizim në mbështetje të produktivitetit të punës. Masat për të zbritur shpenzimet e punës ose për të subvencionuar specialistë shumë të aftë të angazhuar në kërkim dhe zhvillim, ekonomi qarkulluese dhe energji të rinovueshme do të përktheheshin në terma efikasiteti dhe produktiviteti të industrive me intensitet kapital.

REKOMANDIM 7.

Spektori i turizmit, prodhimit, industrisë nxjerrëse, si dhe sektori i TIK-ut kërkojnë më shumë kapital për të përshtatur fuqinë punëtore në nivel sektorial dhe për të përmirë-

suar produktivitetin. Masa rregullatore, standardet e funksionimit apo mbështetja fiskale duke synuar lirim të fondeve brenda firmave dhe intensifikimin e investimeve kapitale me fokus investimet inovative dhe të gjelbra, **do t'i** çonin këta sektorë drejt një qëndrueshmërie të rritjes së produktivitetit.

REKOMANDIM 8.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të hartojë e të udhëheqë një fushatë ndërgjegjësimi e komunikimi me bizneset e institucionet financiare, për të nxitur më shumë financime dhe investime drejt inovacionit. Ekziston një nevojë e madhe për të rritur ndërgjegjësimin e bizneseve/NVM-ve mbi rëndësinë dhe përfitimet e inovacionit dhe K&ZH-së si mënyra për të trajtuar produktivitetin e ulët dhe mungesën e konkurrencës. Masat e politikave që adresojnë K&ZH/inovacionin janë intensifikuar, megjithatë, më shumë duhet bërë për të shtyrë një ndryshim organizativ në nivel firme që të nxiten më shumë financime dhe investime drejt inovacionit.

BIBLIOGRAFIA

DOKUMENTE

- » ERP 2024-2026
- » SZHBI 2021-2027
- » Strategjia Afatmesme për Mbledhjen e të Ardhurave 2022 (Draft)
- » Akt normativ nr. 7 datë 14.12.2023.
- » Ligji 9920/2018 “Për procedurat tatimore” (i ndryshuar)
- » Ligji nr 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”
- » Ligji nr. 92/204 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar
- » Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar)

FAQE TË INTERNETIT

- » <https://www.financa.gov.al/ep-content/uploads/2022/02/Strategjia-Afatmesme-e-t%C3%AB-Ardhurave-2022-2026.pdf>
- » <https://www.tadat.org/performanceAssessmentReports>
- » <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2024/01/12/Albania-2023-Article-IV-Consultation-Press-Release-and-Staff-Report-543731>
- » https://www.oecd-ilibrary.org/development/sme-policy-index-eeastern-balkans-and-turkey-2022_d22fdb37-en_b47d15f0-en.pdf (oecd-ilibrary.org)
- » <https://www.ebrd.com/nees/publications/special-reports/can-the-eeastern-balkans-converge-toeards-eu-living-standards.html>
- » https://www.investment.com.al/ep-content/uploads/2020/04/EN_Technical-Note.pdf
- » <https://www.tatime.gov.al/c/8/42/49/strategjia-dhe-raporte>

Shtojca I

PYETËSORI

SFIDAT E SIPËRMARRJES NË DREJTIM TË NDËRVEPRIMIT FISKAL, INFORMALITETIT DHE PRODUKTIVITETIT

Anketimi mbi “Nderveprimin fiskal, informalitetin dhe produktiviteti ne pune” është një iniciativë e Këshillit të Investimeve. Qëllimi i anketimit është mbështetja e një debati gjithëpërfshirës dhe të bazuar në fakte, të dhëna dhe analiza të shqetësimeve të biznesit në tre fusha kryesore (i) nderveprimin me administratën fiskale DPT, (ii) informaliteti dhe (iii) produktiviteti ne pune.

Gjetjet dhe sugjerimet do të diskutohen në mbledhjet e ardhshme të Këshillit të Investimeve dhe rekomandimet e miratuara do t’i paraqiten Qeverisë Shqiptare për konsiderime të mëtejshme qe mund të sjellin ndryshime apo rishikime ligjore dhe rregullatore me impakt në klimën e investimeve.

1. Viti i regjistrimit të biznesit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

2. Qarku ku kryeni aktivitetin tuaj: *

Mark only one oval.

- ☐ Qarku i Beratit
- ☐ Qarku i Dibrës
- ☐ Qarku i Durrësit
- ☐ Qarku i Elbasanit
- ☐ Qarku i Fierit
- ☐ Qarku i Gjirokastrës
- ☐ Qarku i Korçës
- ☐ Qarku i Kukësit
- ☐ Qarku i Lezhës
- ☐ Qarku i Shkodrës
- ☐ Qarku i Tiranës
- ☐ Qarku i Vlorës

3. Forma e organizimit të biznesit tuaj: *

Mark only one oval.

- ☐ Person Fizik
- ☐ Shoqëri kolektive
- ☐ Shoqëri komandite
- ☐ Shoqëri me përgjegjësi të kufizua
- ☐ Shoqëri aksionere
- ☐ Degë e shoqërive të huaja
- ☐ Zyrë përfaqësimi

4. Aksioneri/Ortaku/Pronari më i madh i biznesit tuaj është: *

Mark only one oval.

- ☐ Femër
- ☐ Mashkull
- ☐ Preferoj të mos përgjigjem

5. Madhësia e biznesit tuaj sipas xhiros të vitit të fundit. Lutemi zgjidhni një opsion *

Mark only one oval.

- ☐ deri në 8 milionë ALL
- ☐ 8 -10 milionë ALL
- ☐ 10 - 14 milionë ALL
- ☐ mbi 14 milionë ALL

6. Cili është numri mesatar i punonjësve në biznesin tuaj? *

Mark only one oval.

- ☐ Deri 9 punonjës
- ☐ 10-49 punonjës
- ☐ 50-249 punonjës
- ☐ Mbi 249 punonjës

7. Numri më i madh i punonjësve tuaj është:

Mark only one oval.

- ☐ Femra
- ☐ Meshkuj

8. Aksionerët/Ortakët më të mëdhenj (me mbi 50% të aksioneve) të biznesit tuaj janë: *

Mark only one oval.

- ☐ Vendas
- ☐ Të huaj
- ☐ Të përbashkët

9. Aktiviteti kryesor ekonomik i biznesit tuaj është: *

Mark only one oval.

- ☐ Bujqësia, pyjet dhe peshkimi
- ☐ Industria nxjerrëse
- ☐ Industria përpunuese
- ☐ Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
- ☐ Ndërtimi
- ☐ Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave
- ☐ Energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar
- ☐ Transporti dhe magazinimi
- ☐ Akomodimi/Hoteleri
- ☐ Shërbimi Ushqimor
- ☐ Agjenci udhëtimi, operator turistik
- ☐ Informacioni dhe Komunikacion
- ☐ Aktivitete Financiare dhe të Sigurimit
- ☐ Aktivitete të Pasurive të Paluajtëshme (real estate)
- ☐ Aktivitete Profesionale, Shkencore dhe Teknike
- ☐ Arsimi
- ☐ Shëndetësia
- ☐ Arte, argëtim dhe çlodhje
- ☐ Aktivitete të tjera shërbimi

10. A jeni biznes eksportues? *

Mark only one oval.

- ☐ Po, Eksportues mbi 70% të shitjeve
- ☐ Po, Eksportues nga 50% - 70%
- ☐ Po, Eksportues më pak se 50%
- ☐ Jo, nuk eksporto

MBI INFORMIMIN,KOMUNIKIMIN DHE PËRDORIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NGA ADMINISTRATËN TATIMORE

11. Si do ta vlerësonit ju ndryshimin e komunikimit të administratës tatimore në dy vitet e fundit:

Mark only one oval.

- ☐ Shumë Pozitiv
- ☐ Pozitiv
- ☐ I Pandryshuar
- ☐ Përkeqësuar
- ☐ Përkeqësuar ndjeshëm

SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT:
INFORMALITETI, PRODUKTIVITETI
DHE INOVACIONI

14. Lutemi vlerësoni kënaqësinë me shërbimet elektronike të DPT. Jepni vlerësimin duke përdorur shkallën e poshtëshënuar të vlerësimit 1– shumë i kënaqur, 2- i kënaqur, 3- disi i kënaqur, 4- i pakënaqur, 5- shumë i pakënaqur

Mark only one oval per row.

	1	2	3	4	5
Aksesi në plotësimin elektronik	☐	☐	☐	☐	☐
Besueshmëria e të dhënave	☐	☐	☐	☐	☐
Saktësia e përpunimit të të dhënave	☐	☐	☐	☐	☐
Shërbimi ndaj klientit (eksistenca e kanaleve të komunikimit/shpejtësia e reagimit/ankimimi/saktësimi i përgjigjeve mbi probleme/etj)	☐	☐	☐	☐	☐

15. Lutem vlerësoni kënaqësinë me shërbimin e klientit të ofruar në lidhje me procesin e fiskalizimit:

Mark only one oval.

- ☐ Shumë i kënaqur
- ☐ I kënaqur
- ☐ Disi i kënaqur
- ☐ I pakënaqur
- ☐ Shumë i pakënaqur

16. Komentoni për pyetjen më sipër:

17. A mendoni se shërbimi tatimpagues/procesi i fiskalizimit/etj ka nevojë për ngritjen e një shërbimi elektronik me telefon (call centre)?

Mark only one oval.

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Other: _____

18. A keni marrë pjesë në sesione trajnimi të ofruara gjatë viteve të fundit nga Administrata Tatimore mbi zbatimin e legjislacionit tatimor?

Mark only one oval.

- ☐ Po
- ☐ Jo

19. Nëse po, Lutem komentoni

20. A keni marrë pjesë në sesione trajnimi të ofruara nga Administrata Tatimore mbi zbatimin e legjislacionit tatimor mbi procesin e fiskalizimit?

Mark only one oval.

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Other: _____

21. Lutemi, nëse keni shprehni komente/sugjerime rreth procesit të fiskalizimit

INFORMALITETI

22. Lutem përcaktoni nëse ndesheni me konkurrencë nga aktivitete informale në sektorin ku operoni?

Mark only one oval.

- ☐ Po
- ☐ Jo

23. Lutemi vlerësoni natyrën që ka informaliteti në sektorin tuaj, duke vlerësuar me 3-fenomenet që shfaqen më shpesh dhe 1- fenomenet që shfaqen më rrallë.

Mark only one oval per row.

	1	2	3
Shmangie taksash	☐	☐	☐
Mosregjistrim	☐	☐	☐
Korrupsion	☐	☐	☐
Punë në të zezë	☐	☐	☐

24. A mendoni qe Fiskalizimi ka adresuar si duhet zbatimin ne praktike te politikave fiskale dhe masat per formalizimin e ekonomise:

Mark only one oval.

☐ Fiskalizimi e ka ulur informalitetin

☐ Fiskalizimi e ka rritur informalitetin

☐ Fiskalizimi nuk ka sjelle ndonjë ndryshim të qënësishëm

☐ Nuk e di

☐ Other: _____

25. Lutem arsyetoni përgjigjen e mësipërme, Pse

26. Për secilin nga faktorët e renditur identifikoni shkallën e influencës në vendimin e një biznesi për të ndërmarrë riskun e një aktiviteti informal (1-faktori më i rëndësishëm, 2- i rëndësishëm, 3- disi i rëndësishëm, 4- nuk është i rëndësishëm, 5- aspak i rëndësishëm):

Mark only one oval per row.

	1	2	3	4	5
Kompleksiteti i legjislacionit tatimor	☐	☐	☐	☐	☐
Zbatimi në praktikë i legjislacionit tatimor	☐	☐	☐	☐	☐
Barra fiskale nivel qëndror – TAP/Tatim Fitimi/TVSH	☐	☐	☐	☐	☐
Barra Fiskale në nivel vendor - Taksa dhe tarifa lokale	☐	☐	☐	☐	☐
Kontrollet Tatimore	☐	☐	☐	☐	☐
Marrëdhëniet me Administratën Tatimore	☐	☐	☐	☐	☐
Konkurrenca e pandershme	☐	☐	☐	☐	☐
Niveli i Korrupsionit	☐	☐	☐	☐	☐
Paqëndrueshmëria fiskale/ndryshimet e shpeshta të legjislacionit fiskal	☐	☐	☐	☐	☐

27. Si mendoni se do të ndikojë në shkallën e informalitetit në sektorin tuaj zbatimi i ligjit të ri mbi të ardhurat?

Mark only one oval.

- ☐ Do të rrisë informalitetin
- ☐ Do të ulë informalitetin
- ☐ Nuk do të ketë ndikim
- ☐ Nuk e di
- ☐ Other: _____

28. Ju lutem arsyetoni përgjigjen e mësipërme, Pse

29. Nga pikëpamja juaj, cilat mund të jenë disa incentive të efektshme për të reduktuar informalitetin në sektorin tuaj?

30. Nëse jeni një biznes që operoni në fushën e Turizmit ku disa shërbime kanë përfituar ulje të TVSH-së në 6%, mendoni se kjo politikë ka sjellë uljen e informalitetit në këtë sektor?

Mark only one oval.

- ☐ Po, ka patur impakt të dukshëm në uljen e informalitetit
- ☐ Jo nuk ka patur ndikim në uljen e informalitetit
- ☐ Other: _____

31. Si do ta vlerësonit ju klimën e të bërit biznes në sektorin ku ju operoni:

Check all that apply.

	Shumë favorizues	Favorizuese	Disi favorizuese	Jo favorizuese	Aspak favorizuese
Regjistrimi	☐	☐	☐	☐	☐
Liçencimi	☐	☐	☐	☐	☐
Marrëdhëniet me administratën publike	☐	☐	☐	☐	☐
Baza ligjore, kompleksiteti i saj	☐	☐	☐	☐	☐
Barra fiskale	☐	☐	☐	☐	☐
Kualifikimi i punonjësve	☐	☐	☐	☐	☐
Proçedurat/kostot e kredimarrjes	☐	☐	☐	☐	☐

32. Lutemi komentet tuaja apo sugjerime mbi problematika te ndeshura nga bizneset ne fushen e turizmit per sa i perket administrimit fiskal, klimes se investimeve dhe informalitetit per tu konsideruar ne vijim gjate punes se Keshillit te Investimeve

Produktiviteti dhe Inovacioni

33. Nga faktorët e mëposhtëm, të lidhur direkt me kompaninë tuaj cilët mund tëkonsiderohen 3 pengesat kryesore në integrim në zinxhirët ndërkombëtar të vlerës:

Check all that apply.

- ☐ Inovacioni dhe Teknologjia në kompani
- ☐ Aftësitë menaxheriale
- ☐ Cilësia e Forcës së punës të kompanisë
- ☐ Disponueshmëria e forcës së punës
- ☐ Mungesa në informacion mbi tregjet e synuara nga kompania
- ☐ Konkurrueshmëria në tregjet e synuara nga kompania (Standardi, procedura, tarifa etj)
- ☐ Pronësia (e kompanisë) e huaj
- ☐ Other: _____

34. Nga faktorët e mëposhtëm të lidhur indirekt me kompaninë tuaj, cilët mund tëkonsiderohen 3 pengesa kryesore në integrim në zinxhirët ndërkombëtar tëvlerës:

Check all that apply.

- ☐ Informaliteti
- ☐ Aksesit në Financim
- ☐ Infrastruktura (rrugë, porte, aeroportë etj)
- ☐ Logjistika (magazininim, procedure, etj)
- ☐ Lehtësimi i tregtisë
- ☐ Politikat tregtare
- ☐ Aksesit në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit
- ☐ Other: _____

35. A ka ndikuar rritja e pagës në institucionet publike tek pagat në kompaninë tuaj:

Mark only one oval.

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk mendoj që duhet të ketë ndikim
- ☐ Other: _____

36. Cila mase rregullatore ju ka ndihmuar te rrisni produktivitetin ne kompanine tuaj?

Mark only one oval.

- ☐ Rritja e pagës
- ☐ Rritja e trajnimeve brenda/jashtë kompanisë
- ☐ Ndërhyrja e shtetit nëpërmjet uljes taksave/subvencionimit etj
- ☐ Other: _____

37. C'farë vendi zë zhvillimi dhe futja e inovacionit (sa vëmendje i kushtohet) në kompaninë tuaj? Vlerësoni nga 1 deri në 5 ku 1=Aspak dhe 5=Shumë)

Mark only one oval.

- ☐ 1
- ☐ 2
- ☐ 3
- ☐ 4
- ☐ 5

38. A ka kompania juaj një fond të dedikuar për Kërkim dhe Zhvillim?

Mark only one oval.

- ☐ Po, kemi fond te dedikuar
- ☐ Jo, nuk kemi fond te dedikuar por sipas rasteve
- ☐ Jo, nuk kemi sepse nuk na duhet
- ☐ Other: _____

39. Nëse kompania juaj ka një fond të dedikuar për Kërkim dhe Zhvillim, Lutem cilësoni sa % të buxhetit

40. A ka kompania juaj një fond të dedikuar për trajnimin e punonjësve?

Mark only one oval.

- ☐ Po
- ☐ Jo, nuk kemi fond te dedikuar por sipas rasteve
- ☐ Jo, nuk kemi sepse nuk na duhet
- ☐ Other: _____

41. Nëse kompania juaj ka një fond të dedikuar për trajnimin e punonjësve, Lutem specifikoni sa % e buxhetit?

42. Lutemi shprehni komentete të tjera apo sugjerime mbi problematika që kanë të bëjnë me administrimin fiskal dhe klimën e investimeve për t'u konsideruar në vijim gjatë punës së Këshillit të Investimeve.

SFIDAT E SIPËRMARRJES PËR TË SIGURUAR PAJTUESHMËRINË ME KUADRIN LIGJOR DHE RREGULLATOR?

Si ka ndryshuar barra e përgjithshme rregullatore mbi biznesin tuaj gjatë tre viteve të fundit?

Mark only one oval.

- ☐ Eshte rritur
- ☐ Eshte ulur
- ☐ Nuk ka ndryshuar
- ☐ Other: _____

Nëse vlerwsoni barrën rregullatore që prek biznesin tuaj, krahasuar me situatën e një viti më parë?

Mark only one oval.

- ☐ Eshte rritur
- ☐ Eshte ulur
- ☐ Nuk ka ndryshuar
- ☐ Other: _____

A jeni në dijeni nëse gjatë tre viteve të fundit në nivelin qendror dhe lokal janë zbatuar nisma për të ulur koston e pajtueshmërisë me kuadrin rregullator për biznesin?

Mark only one oval.

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di
- ☐ Other: _____

Nëse i jeni përgjigjur "po" pyetjes, ju lutemi specifikoni nëse iniciativat kanë ndihmuar për të kursyer kohë dhe/ose para të biznesit tuaj?

Mark only one oval.

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☐ Nuk e di
- ☐ Other: _____

Cilat aspekte rregullatore janë më të rëndat për biznesin tuaj për sa i përket kohës dhe parave të shpenzuara për pajtueshmërinë me to?

Cila nga fushat e mëposhtme shkakton një barrë administrative për ndërmarrjen tuaj, e matur orë pune dhe/ose kostove të shkaktuara? (Vendosni sektorët që shkaktojnë një ngarkesë sipas rendit të përparësisë (1 = barra më e lehtë, 5 = barra më e rëndë).

Mark only one oval per row.

	1	2	3	4	5
Legjislacioni i punës dhe rregullore të tjera të jetës së punës	☐	☐	☐	☐	☐
Legjislacioni Tatimor	☐	☐	☐	☐	☐
Legjislacioni mjedisor	☐	☐	☐	☐	☐
Legjislacioni i konkurrencës	☐	☐	☐	☐	☐
Rregulloret e të dhënave personale	☐	☐	☐	☐	☐
Prokurimet publike	☐	☐	☐	☐	☐
Mbrojtja e konsumatorit	☐	☐	☐	☐	☐
legjislacioni ne fushen e kontabiliteti dhe auditimit	☐	☐	☐	☐	☐
Legjislacioni i tregtar	☐	☐	☐	☐	☐
Çështjet që lidhen me doganat	☐	☐	☐	☐	☐

A ka ligje dhe rregullore që lehtësojnë punën e ndërmajes tuaj apo që ju duket e dobishme dhe nëse po, a mund të jepni disa shembuj?

A ka ligje dhe rregullore që vështirësojnë punën e ndërrmarjes tuaj apo që nuk ju duket e dobishme dhe nëse po, a mund të jepni disa shembuj?

SHTOJCA II

GJETJET E PYETËSORIT



SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT: INFORMALITETI, PRODUKTIVITETI DHE INOVACIONI

Shkurt 2024

SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT:
INFORMALITETI, PRODUKTIVITETI
DHE INOVACIONI

OBJEKTI & METODOLOGJIA



OBJEKTI I VROJTIMIT

- (i) Ndërveprimin me administratën fiskale DPT
- (ii) Informaliteti
- (iii) Inovacioni dhe produktiviteti në punë



METODOLOGJIA

- Pyetësor i strukturuar
- Dërguar me email kompanive
- Pyetësorë të plotësuar online në mënyrë anonime nga 601 biznese
- Anketa përfshin të dhëna të raportuara gjatë periudhës janar – shkurt 2024

KONKLUZIONE - ANKETIMI

01

KOMUNIKIM I PËRMIRËSUAR

Komunikimi me administratën tatimore qendrore është përmirësuar dhe përmirësimi ka qënë i vazhdueshëm.

02

DIGJITALIZIMI I MIRËPRANUAR

Biznesi është mjaftueshëm i kënaqur me shërbimet elektronike krahasimisht me vitin 2022 pavarësisht se ende ka vend për përmirësim kryesisht në elementë të besueshmërisë së të dhënave dhe shërbimit ndaj klientit.

03

FISKALIZIMI

Ka një rritje në vlerësim nga viti 2022 në drejtim të shërbimit të klientit në sistemin e fiskalizimit, por ende shprehet nevoja e ekzistencës së një kanali komunikimi (*call centre*) në mbështetje të përdoruesve. Fiskalizimi vlerësohet në ndikimin e tij në ulje të informalitetit në vend, por me rritje të kostove ndaj bizneseve.

04

TRAJNIME LIGJORE NË RRITJE

Biznesi ka rritur pjesëmarrjen e tij në trajnime të DPT – edhe pse ende në shifra të ulta.

05

PERCEPTIM I INFORMALITETIT

Në masë të konsiderueshme, biznesi pranon ekzistencën e informalitetit, më shumë se në vitin 2019, por më pak se në vitin 2022. Më shumë informalitet perceptojnë, bujqësia, industria përpunuese dhe shërbimet. Energjia percepton më pak informalitet krahasimisht me sektorët e tjerë. Informaliteti në formën më të lartë shfaqet si shmangie e taksave, puna në të zezë dhe mosregjistrim, trend ky i ruajtur në vite.

KONKLUZIONE - ANKETIMI

06

FAKTORI MË I RËNDËSISHËM

që nxit Informalitetin është barra fiskale në nivel qendror, e cila ka zëvendësuar konkurrencën e pandershme në vitet 2019 – 2022. Ligji i ri mbi të ardhurat, vazhdon të konsiderohet si një element i cili do të shtojë informalitetin në vend.

07

ULJA E TVSH-SË NË TURIZËM

ka ulur informalitetin sipas perceptimit të vetë sektorit.

08

KLIMA E BIZNESIT

është përmirësuar në drejtim të regjistrimit dhe licencimit, por jo përsa i përket procedurave/kostove të kredimarrjes dhe barrës fiskale në vend.

09

DISPONUESHMËRIA E FORCËS PUNËTORE

konsiderohet disfavori kryesor në vitin 2024, në një kohë kur në vitin 2022 disponueshmëria ishte faktori i katërt në radhë i konsideruar si pengesë në integrim. Informaliteti konsiderohet ende pengesë kryesore në integrim për kompanitë shqiptare.

10

PRODUKTIVITETI

Kompanitë mendojnë se janë njëlloj produktive brenda vendit, por janë më pak produktive kur krahasohen me kompanitë që operojnë jashtë vendit.

11

TRAJNIMI I VAZHDUESHËM

së bashku me rritjen e pagave mund të sjellin rritje të produktivitetit në punë sipas perceptimit të biznesit. Në masë të konsiderueshme, biznesi deklaron marrjen e masave për rritjen e produktivitetit në punë.

12

RRITJA E MBËSHTETJES SHTETËRORE

drejt subvencionimit, trajnimit dhe teknologjive do të ndihmonte kompanitë në vend të rrisnin produktivitetin në punë.

13

INOVACIONIT I KONSIDEROHEJ VËMENDJE E KONSIDERUESHME

nga ana e kompanive më shumë gjatë vitit 2021 (periudha pas pandemisë) edhe pse jo i mbështetur me një fond të dedikuar, krahasuar me vitin 2024. Kompanitë në të shumtën e rasteve trajnojnë punonjësit bazuar në nevoja të momentit dhe nuk kanë një linjë të vazhdueshme e të dedikuar për këtë.

14


BARRA RREGULLATORE

si kosto shtesë për biznesin në masë më të madhe vlerësohet të jetë barra fiskale dhe inspektoriatet (numri dhe frekuenca e inspektimeve).


SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT: INFORMALITETI, PRODUKTIVITETI DHE INOVACIONI

PROFILI I KAMPIONIT 601 BIZNESE


Forma e organizimit të biznesit tuaj (% totalit):




Qarku ku kryeni aktivitetin tuaj (% totalit):




Mosha e kompanisë tuaj (% totalit):




Sektori (% totalit)



Madhësia e biznesit tuaj sipas
xhiros të vitit të fundit (% totalit)



Cili është numri mesatar i punonjësve
në biznesin tuaj (% totalit)?




KOMUNIKIMI ME DPT




Krahasimi në vite tregon se komunikimi me DPT **perceptohet pozitiv** dhe kryesisht jo në përkeqësim.

52% perceptojnë komunikim **pozitiv/shumë pozitiv** ndërkohë 32% e konsiderojnë komunikimin të pandryshuar.


Si do ta vlerësonit ju ndryshimin e komunikimit të administratës tatimore në dy vitet e fundit?



Si do ta vlerësonit ju komunikimin me administratën tatimore në dy vitet e fundit (% totalit)? (2024)



Si do ta vlerësonit ju komunikimin me administratën tatimore në dy vitet e fundit (% totalit)? (2024)



Vlerësimi është i njëjtë si për administratorët femra ashtu edhe për ata meshkuj përsa i përket përmirësimit të komunikimit me administratën tatimore.

SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT: INFORMALITETI, PRODUKTIVITETI DHE INOVACIONI


KËNAQËSIA ME SHËRBIMET ELEKTRONIKE TË DPT




Kënaqësia me shërbimet elektronike edhe pse **në rritje krahasuar me vitin 2022, ende është më e ulët se viti 2019**, në të tre elementët e vlerësuar.

Aksesi në shërbimet elektronik të DPT është elementi më i vlerësuar nga biznesi ndërsa **shërbimi ndaj klientit dhe besueshmëria e të dhënave kanë vlerësimin më të ulët** nga ana e përdoruesve për vitin 2024.

Vlerësoni kënaqësinë me shërbimet elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve **“i kënaqur/shumë i kënaqur”**



Kënaqësia me shërbimet elektronike të DPT (2024) **“Shumë i kënaqur”**




FISKALIZIMI SHËRBIMI I KLIENTIT



Krahasuar me vitin 2022 **ka një rritje në vlerësimin e shërbimit** të klientit në lidhje me procesin e fiskalizimit.

Vlerësoni kënaqësinë me shërbimin e klientit të ofruar në lidhje me procesin e fiskalizimit



FISKALIZIMI – SHËRBIMI I KLIENTIT




Afërsisht 1 **në 6 kompani shprehin kënaqësi me shërbimin e klientit** përse i përket procesit të fiskalizimit, por 1 në 7 kompani shprehen se ky shërbim **ka nevojë për ngritjen e një qendre thirrjesh (call center)** në përgjigje të përdoruesve, i njëjti trend sikundër 2 vite më parë.



TRAJNIME LIGJORE DPT



Pavarësisht numrit të ulët të bizneseve që kanë marrë pjesë në trajnimet e DPT, krahasuar me vitet e mëparshme **vihet re një rritje e bizneseve** që marrin pjesë në trajnime të tilla.




INFORMALITETI




Perceptimi i biznesit ndaj **informalitetit vazhdon të jetë në nivele të larta**, më shumë se një në 7 kompani mendon se përballet me informalitetin në aktivitetin e tij.

Trendi është disi më i ulët krahasuar me vitin 2022 edhe pse **në rritje krahasuar me vitin 2019**.

Lutem përcaktoni nëse ndesheni me konkurrencë nga aktivitete informale në sektorin ku operoni?




Lutem përcaktoni nëse ndesheni me konkurrencë nga aktivitete informale në sektorin ku operoni? (2024)




INFORMALITETI

Lutem përcaktoni nëse ndesheni me konkurrencë nga aktivitete informale në sektorin ku operoni? (2024)



INFORMALITETI
- PERCEPTIMI I BIZNESIT

Lutemi vlerësoni natyrën që ka informaliteti në sektorin tuaj: (2024)




Shmangia e taksave konfirmohet **si forma kryesore e shfaqjes së informalitetit** në vite, e ndjekur nga puna në të zezë dhe mosregjistrimi.




Bujqësia, tregtia dhe shërbimet janë sektorët me perceptiminin më të lartë të informalitetit.

Lutemi vlerësoni natyrën që ka informaliteti në sektorin tuaj: (2022)




Lutemi vlerësoni natyrën që ka informaliteti në sektorin tuaj: (2019)




SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT:
INFORMALITETI, PRODUKTIVITETI
DHE INOVACIONI

NATYRA E INFORMALITETIT
SIPAS SEKTORËVE


Lutemi vlerësoni natyrën që ka informaliteti në sektorin tuaj: (2024)



Lutemi vlerësoni natyrën që ka informaliteti në sektorin tuaj: (2022)



Perceptimi i biznesit mbi natyrën e informaliteti: (2019)




FAKTORI MË I RËNDËSISHËM
QË NXIT INFORMALITETIN




Konkurrenca e pandershme si faktori kryesor që nxit informalitetin sipas perceptimit të biznesit **gjatë viteve 2019, 2022 është zëvendësuar me barrën fiskale në nivel qendror gjatë 2024.**

Renditja sipas rëndësisë mbi Informalitetin (2019)
"i rëndësishëm/shumë i rëndësishëm"




Për secilin nga faktorët e renditur identifikoni shkallën e influencës në vendimin e një biznesi për të ndërmarrë riskun e një aktiviteti informal? (2024)

"i rëndësishëm/shumë i rëndësishëm"



Për secilin nga faktorët e renditur identifikoni shkallën e influencës në vendimin e një biznesi për të ndërmarrë riskun e një aktiviteti informal? (2022)

"i rëndësishëm/shumë i rëndësishëm"




INFORMALITETI

“


Fiskalizimi ka ndikuar në uljen e informalitetit bazuar në perceptimin e biznesit, 65% e të anketuarve.

Ndërkohë gjysma e kompanive perceptojnë rritje të kostove të administrimit.

A mendoni që fiskalizimi ka adresuar si duhet zbatimin në praktikë të politikave fiskale dhe masat për formalizimin e ekonomisë? (2024)



A ka ndikuar fiskalizimi në kostot e administrimit fiskal? (2024)




LIGJI I RI MBI TË ARDHURAT

“

48% e kompanive perceptojnë se ligji i ri mbi të ardhurat, do të rrisë informalitetin në vend, i njëjti trend si dy vjet më parë.

Ndryshimi në këtë rast ka të bëjë me kompanitë që janë në mëdyshje në lidhje me efektet e Ligjit të ri të të Ardhurave.

Si mendoni se do të ndikojë në sektorin tuaj zbatimi i ligjit të ri mbi të ardhurat në shkallën e informalitetit?



SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT: INFORMALITETI, PRODUKTIVITETI DHE INOVACIONI


ULJA E TVSH-së NË TURIZËM

“


38% e kompanive në total mendojnë se ulja e TVSH në turizëm nuk ka sjellë edhe ulje të informalitetit.

Ndërkohë, vetë sektori i turizmit, 4 në 10 kompani mendojnë se ulja e TVSH-së ka patur impakt të dukshëm në uljen e informalitetit.

Në fushën e turizmit ku disa shërbime kanë përfutur ulje të TVSH-së në 6%, mendoni se kjo politikë ka sjellë uljen e informalitetit në këtë sektor? (2024)



Në fushën e turizmit ku disa shërbime kanë përfutur ulje të TVSH-së në 6%, mendoni se kjo politikë ka sjellë uljen e informalitetit në këtë sektor? (2024)



KLIMA E TË BËRIT BIZNES


“

Regjistrimi dhe licencimi konsiderohen si elementë më favorizues nga ana e të anketuarve.

Ndërkohë, procedurat/kostot e kredimarrjes dhe barra fiskale janë elementët më pak favorizues për kompanitë e anketuara.

Si do ta vlerësonit ju klimën e të bërit biznes në sektorin ku ju operoni, bazuar në elementët e mëposhtëm? (2024)


"lehtësuese"




KONKURRUESHMËRIA

Në 2024, **disponueshmëria e forcës punëtore konsiderohet disfavor**, në një kohë kur në vitin 2022 disponueshmëria ishte faktori i katërt në radhë.

Nga faktorët e mëposhtëm të lidhur direkt me kompaninë tuaj, cilët mund të konsiderohen 3 pengesa kryesore në integrim në zinxhirët ndërkombëtar të vlerës? (2022)




Nga faktorët e mëposhtëm, të lidhur direkt me kompaninë tuaj cilët mund të konsiderohen 3 pengesat kryesore në integrim në zinxhirët ndërkombëtar të vlerës? (2024)



KONKURRUESHMËRIA

Duke përkufizuar produktivitetin e punes si vlerën (monetare) që merr kompania nga një ditë pune e punonjësve tuaj, si do ta vlerësonit ju produktivitetin e tyre në raport me atë të kompanive të tjera në sektorin ku operoni? (2024)

Më shumë se 4 në 10 kompani **perceptojnë se janë njësoj produktive** me konkurrentët në vend.




PRODUKTIVITETI

Në vitin 2024, **informaliteti, politikat tregtare dhe aksesimi në financim** konsiderohen pengesa kryesore në integrim.

Informaliteti ishte pengesa kryesore e identifikuar edhe në vitin 2022, ndërsa në vend të dytë ishte aksesimi në financim, i ndjekur nga politikat tregtare.


Nga faktorët e mëposhtëm të lidhur indirekt me kompaninë tuaj, cilët mund të konsiderohen 3 pengesa kryesore për integrim në zinxhirët ndërkombëtar të vlerës?



Sektorë si energjia apo TIK **konsiderojnë punonjësit e tyre të jenë më produktivë** se konkurrenca brenda vendit.

Ndërsa sektorë më tradicionalë **konsiderojnë punonjësit e tyre të jenë njëllorj produktivë** brenda vendit.


Duke përkufizuar produktivitetin e punës si vlerën (monetare) që merr kompania nga një ditë pune e punonjësve tuaj, si do ta vlerësonit ju produktivitetin e tyre në raport me atë të kompanive të tjera në sektorin ku operoni? (2024)



PRODUKTIVITETI


Duke përkufizuar produktivitetin e punës si vlerën (monetare) që merr kompania nga një ditë pune e punonjësve tuaj, si do ta vlerësonit ju produktivitetin e tyre në raport me atë të kompanive të huaja, me të cilat bashkëpunoni? (2024)

“Më shumë se 4 në 10 kompani **perceptojnë se janë më pak produktivë** se të ngjashmit e tyre jashtë vendit.




“Turizmi dhe TIK perceptojnë një **produktivitet deri diku të njëjtë me konkurrencën e huaj** në dallim nga sektorët e tjerë që perceptojnë të jenë shumë më pak produktivë se konkurrenca e huaj.

Duke përkufizuar produktivitetin e punës si vlerën (monetare) që merr kompania nga një ditë pune e punonjësve tuaj, si do ta vlerësonit ju produktivitetin e tyre në raport me atë të kompanive të huaja, me të cilat bashkëpunoni? (2024)




PRODUKTIVITETI

A ju ndodh gjatë një dite pune, të pezulloni punën për shkak të një avarie (p.sh. ndërprerje elektriciteti, sistemi nuk punon, po prisni një proces tjetër pune të përfundojë, etj.)? (2024)




Nëse po, ju lutem specifikoni në terma kohorë, në mënyrë të përafërt, sa minuta janë këto ndalesa? (2024)



“**Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve së bashku me rritjen e rrogës së punonjësve** dhe bashkëpunimi me bizneset e huaja konsiderohen si masat kryesore në rritje të produktivitetit.

Cila nga masat e mëposhtme mendoni se janë 3 më kryesoret që do të ndihmonin kompaninë tuaj të përmirësonte produktivitetin e punës? (2024)




PRODUKTIVITETI




77% e kompanive planifikojnë marrjen e masave për rritjen e produktivitetit të tyre në punë ku **1 në 2 kompani synon një rritje më shumë se 5% të tij.**

Nëse ju si kompani mendoni të aplikoni masa për rritjen e produktivitetit të punës, sa mendoni se këto masa do të rrisin produktivitetin? (2024)



36% e kompanive presin rritje deri në 5% në përgjigje të marrjes së masave për rritje të produktivitetit.

Nëse ju si kompani mendoni të aplikoni masa për rritjen e produktivitetit të punës, sa mendoni se këto masa do të rrisin koston e aktivitetit tuaj? (2024)




46% e kompanive deklarojnë se kanë rritur pagat në ndjekje të politikës së qeverisë për rritjen e pagave në sektorin publik.




Ndërhyrja e shtetit në formën e uljes së taksave/subvencionimeve, etj., konsiderohet masa rregullatore më e mbështetur nga biznesi (1 në 3 kompani).

Çfarë masash rregullatore, do të sugjeroni të bëheshin pjesë e politikave ekonomike me synim rritjen e produktivitetit të punës në kompaninë tuaj (zgjidhni deri në 3 masa)? (2024)



A ka ndikuar rritja e pagës në institucionet publike tek pagat në kompaninë tuaj? (2024)



PRODUKTIVITETI


INOVACIONI



Më shumë se 4 në 10 kompani **i japin vëmendje të konsiderueshme inovacionit** në kompaninë e tyre; Ndërsa 1 në 5 kompani nuk i kushton fare vëmendje.

Të dhënat **janë në përkeqësime** krahasuar me vitin 2021.

Çfarë vendi zë zhvillimi dhe futja e inovacionit (sa vëmendje i kushtohet) në kompaninë tuaj?




■ 2021 ■ 2024



Në përgjithësi fondet në lidhje me K&ZH alokohen sipas rastit specifik dhe **vetëm 6% deklarojnë se kanë fond të dedikuar për K&ZH** —treguesë në përkeqësime krahasuar me vitin 2021.

A ka kompania juaj një fond të dedikuar për Kërkim dhe Zhvillim?



■ 2021 ■ 2024


SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT: INFORMALITETI, PRODUKTIVITETI DHE INOVACIONI

INOVACIONI



Kompanitë duket se **trajnojnë punonjësit vetëm sipas rastit** dhe nuk kanë fonde të dedikuara për trajnim.


A ka kompania juaj një fond të dedikuar për trajnimin e punonjësve?



■ 2021 ■ 2024

BARRA RREGULLATORE

Si ka ndryshuar barra e përgjithshme rregullatore mbi biznesin tuaj gjatë tre viteve të fundit? (2024)



6 në 10 kompani kanë deklaruar **rritje të barrës rregullatore ndaj biznesit** në 3 vitet e fundit.

BARRA
RREGULLATORE




Informacioni dhe komunikacioni, ndërtimi dhe shërbimet janë sektorët që perceptojnë rritje të barrës rregullatore në tre vitet e fundit.

Energjia, industria dhe bujqësia perceptojnë më pak rritje të barrës rregullatore.

Si ka ndryshuar barra e përgjithshme rregullatore mbi biznesin tuaj gjatë tre viteve të fundit? (2024)


"është rritur"



A jeni në dijeni nëse gjatë tre viteve të fundit në nivelin qendror dhe lokal janë zbatuar nisma për të ulur koston e pajtueshmërisë me kuadrin rregullator për biznesin? (2024)



64% nuk kanë dijeni nëse ka nisma për uljen e koston së pajtueshmërisë me kuadrin rregullator.




SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT:
INFORMALITETI, PRODUKTIVITETI
DHE INOVACIONI

BARRA
RREGULLATORE




Nga 9% e kompanive që deklarojnë se kanë dijeni për marrjen e masave për uljen e kostove të pajtueshmërisë me kuadrin rregullator, **gati 6 në 10 kompani deklarojnë se incentivat kanë kursyer kohë/para në aktivitetin e tyre.**

Ju lutemi specifikoni nëse iniciativat kanë ndihmuar për të kursyer kohë dhe/ose para të biznesit tuaj? (2024)



Legjislacioni tatimor vlerësohet si fusha me barrën administrative më të rëndë për kompanitë e ndjekur nga inspektimet/frekuenca e inspektimeve.

Cila nga fushat e mëposhtme shkakton një barrë administrative për ndërmarrjen tuaj, e matur në orë pune dhe/ose kostove të shkaktuara? (2024)



Shtojca III

POLITIKA FISKALE DHE TVSH NË SHQIPËRI

Politikat fiskale kanë një ndikim të rëndësishëm në ekonomi, duke ndikuar në performancën e të ardhurave publike, sjelljen e agentëve ekonomikë, rritjen ekonomike, rishpërndarjen e të ardhurave, investimet dhe punësimin, si dhe stabilitetin makroekonomik. Politikat fiskale të lidhura me TVSH-në kanë ndikim në:

- » Konsum
- » Investime
- » Konkurrencë
- » Financat publike

Ndikimi në konsum: Ndryshimet në normat e TVSH-së mund të ndikojnë në vendimet e konsumatorëve. Një rritje e normës së TVSH-së mund të çojë në çmime më të larta për mallra dhe shërbime, të cilat mund të ulin fuqinë blerëse të konsumatorëve dhe të ulin kërkesën në treg për to. Në të kundërt, një ulje e normës

së TVSH-së duke i bërë produktet më të lira, stimulon konsumin që shkon drejtpërdrejtë në rritjen e kërkesës, por edhe ofertës, duke ndikuar në rritjen e produktivitetit.

Stimujt e investimeve: Politikat fiskale që lidhen me normën e TVSH-së mund të kenë gjithashtu ndikim në investimet e biznesit. Stimujt të tillë tatimorë për sektorë të caktuar ose investime specifike mund të inkurajojnë bizneset të investojnë më shumë, në to, gjë që shkon në nxitje të rritjes ekonomike.

Konkurrueshmëria e brendshme dhe ndërkombëtare: Politikat që lidhen me TVSH-në mund të ndikojnë në konkurrencën e brendshme, pozitivisht kur ato nuk nxisin diferencimet brenda një sektori a industrie, si dhe në tregun ndërkombëtar kur ato nuk përputhen me të njëjtët aplikime me rajonin a më gjerë. Normat e larta të TVSH-së mund t'i bëjnë produktet vendase

më të shtrenjta në krahasim me produktet e importuara, gjë që mund të dobësojë konkurrencën e bizneseve vendase.

Menaxhimi i financave publike: Të ardhurat nga TVSH-ja përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave tatimore mbledhura nga qeveria. Prandaj, politikat tatimore të lidhura me TVSH-në luajnë një rol vendimtar në menaxhimin e financave publike dhe në financimin e investimeve dhe shërbimeve publike.

DISA NDIKIME TË POLITIKAVE LIDHUR ME ZBATIMIN E TVSH.

TVSH e reduktuar për strukturat akomoduese.

Përfshihen në fushën e normës së reduktuar të TVSH prej 6%, të gjitha strukturat e shërbimit të akomodimit (hotelerisë e disa furnizime të tjera mallrash e shërbimesh), duke dhënë impakt pozitiv në perceptimin e uljes së informalitetit, sipas një pjese të rëndësishme të të anketuarve.

Ndërkohë aplikimi i një norme të reduktuar të TVSH-s për sektorin e turizmit sipas bazës ligjore në fuqi paraqitet :

- a) Norma e reduktuar e TVSH-së, aplikohet për shërbimin e akomodimit në strukturat akomoduese, konkretisht për fjetjen përfshirë mëngjesin. Ajo nuk zbatohet për të tjera shërbime si bare, restorante, pishina etj
- b) Norma e reduktuar e TVSH-së aplikohet për çdo shërbim të ofruar brenda strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".

TVSH e përjashtuar mbi një prag për investimet: Është i përjashtuar nga zbatimi i TVSH-së, Importimi i makinerive dhe pajisjeve, në funksion

të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë mbi 500 milione ALL. Më parë ky prag përjashtimi ka qenë dhjetë herë më i ulët. Rritja e menjëhershme e këtij pragu krijon një hendek përtej të cilit përfitues mbetën një numër i kufizuar biznesesh, kryesisht ato që operojnë në fushën e energjitikës. Por në kushtet kur pothuaj 90% e bizneseve në vend, konsiderohen të vegjël e të mesëm, ato nuk nxiten të investojnë. *TVSH e përjashtuar për importimi e jahteve dhe mjeteve të tjera ujore, që perdoren për qëllime turistike, kenagesie dhe argetimi.*

Kjo masë nuk është në përputhje me direktivën europiane të TVSH-së, duke ndikuar direkt në rritjen e përjashtimeve, pa sjellë shumë efikasësi. Mundet pjesërisht impakti të jepet për një numur të kufizuar operatorësh, por pa influencë në sektorin e turizmit në përgjithësi. Ndërkohë që grupe interesi me peshë në sektorët ku operojnë kërkojnë reduktim të normës së TVSH për disa produkte ushqimore bazë, por që akoma nuk kanë zënë vend në një tryezë diskutimi.

TVSH e reduktuar jo njëtrajtësisht për disa shërbime të së njëjtës natyrë.

Furnizimi i shërbimit dhe pjesërisht të mallrave, nga Strukturat Akomoduese, hotelet / resorted me pesë yje, strukturat e certifikuara në agroturizëm dhe taksohet me normë të reduktuar të TVSH-së prej 6%. Por kjo normë zbatohet e diferencuar si midis strukturave të mësipërme edhe brenda një strukture. Një grup aplikon shkallën e reduktuar vetëm për fjetjen, një tjetër aplikon këtë shkallë për cdo lloj furnizimi të mallit a shërbimit, ndërsa grupi i agrobiznesit nuk mund t'a aplikojë shkallën e reduktuar vetëm për shitjet e pijeve të cdo lloj qofshin. Diferencime të tilla përveçse komplikojnë zbatimin, rrisin koston administrative

të administratës tatimore, rrisin edhe rriskun e prirjeve evazioniste.

Zbatimi i TVSH në sektorët e agropërpunimit dhe bujqësor.

Duke filluar nga vitit 2022, janë bërë ndryshime që kanë rënduar bizneset, bujqit dhe vetë konsumatorët.

A. Skema e kompensimit të TVSH-së për agropërpunuesit, ndryshoi tërësisht.

Me vendosjen e normës zero të kompensimit, efektivisht kjo skemë është bërë e vështirë për t'u zbatuar, pasi nuk ekziston më stimuli për pjesëmarrësit në skemë, qofshin ato fermerë, apo grumbullues-përpunues. Në këtë rast politike ndjekur, vetëm i rriti vështirësitë e problematikave sektoriale, duke u nisur nga informaliteti, rritjet e kostos, reduktimit të përfitimeve për aktorët. Perceptimi i rritjes së informalitetit nga të anketuarit, është domethënës dhe duhet kuptuar drejt. Mirë do të ishte që të ishte kryer një studim për të gjitha problematikat e këtij sektori, me përfshirje të ministrive

të financave dhe të bujqësisë, përfaqësuesve të sektorit të agro-përpunimit hde vetë fermerëve, më pas të përfundohej me politika të përshtatshme fiskale.

B. TVSH në furnizimin e inputeve bujqësore.

Furnizimi i inputeve bujqësore (plehurat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët) ka qenë i përjashtuar nga TVSH. Por, u përfshi ndër furnizimet e tatueshme, me shallë tatimore prej 10%, që gjithsesi ndikoi në rritje të cmimit të këtyre inputeve.

Ndryshimi i shpeshtë i pragut të regjistrimit në TVSH

Për dhjetë vjet ka ndryshuar tre herë pragu i regjistrimit në TVSH. Nga 5 milionë, në 2 milionë. (që rezultoi me kosto të rritur për mijëra biznese të vogla) vetëm pas dy vitesh bëhet 10 milionë. Pa u ndikuar nga pozitat e cdo grupi interesi të përfshirë në fushën e zbatimit të TVSH-së, të tilla ndryshime japin ndikim serioz në bazën e tatueshme të TVSH, prandaj mirë është që të paraprihen nga studime të përpikta.

Shtojca IV

REKOMANDIME TË KI PËR POLITIKËN FISKALE 2015-2023

“PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË DIGJITALIZUARA NDAJ BIZNESIT ” - TETOR 2023

REKOMANDIMI 11

Ri-inxhinierimi i praktikave administrative dhe procedurave që lidhen me depozitimin e pasqyrave financiare duke përfituar nga funksionalitetet që ofron digjitalizimi, si një mundësi për të ulur barrën administrative si për biznesin ashtu edhe për administratën. Aktualisht, ka një barrë administrative të shtuar për biznesin që lidhet me depozitimin e pasqyrave financiare sipas formateve të ndryshme, në dy institucione, respektivisht DPT dhe QKB dhe sipas detyrimeve ligjore që rrjedhin nga dy ligje të ndryshme. Konkretisht mbështetur në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar, neni 43, pika 3 (a), subjektet kanë detyrimin të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së vep-

rimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme. Depozitimi i tyre bëhet aktualisht online në QKB në format elektronik dhe deri në 31 korrik të vitit pasardhës. Ndërkohë, që një detyrim të ngjashëm bizneset e kanë edhe në bazë të nenit 22 të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, duke bërë dorëzimin e pasqyrave financiare dhe anekseve shpjeguese në DPT brenda 7 muajve nga momenti i raportimit (31 mars i vitit pasardhës). Nisur nga qëllimi që ka procesi i digjitalizimit të informacionit dhe procedurave, për të thjeshtuar dhe lehtësuar hapat burokratikë që kryhen apo administrohen nga institucionet e administratës publike dhe për të rritur efikasitetin e tyre sipas konceptit shërbim me një ndalesë (“one-stop shop”), unifikimi i procedurave të mësipërme do të ishte një masë e arsyeshme, më përfitueshmëri të ndërsjelltë dhe do të kërkonte vetëm pak ndryshime ligjore në bazën e mësipërme.

“NGA PAGAT E ULËTA, TEK PRODUKTIVITETI” - PRILL 2023

REKOMANDIMI 4

» Punësimi me kohë të pjesshme dhe kontributet sociale: Pavarësisht masave të ndëmarra, punësimi i padeklaruar vijon i lidhur drejtpërdrejt me ekonominë informale dhe produktivitetin e ulët të NMVM-ve. Ky problem sistematik është evident si në punësimin plotësisht të peregjistruar ashtu edhe në atë pjesërisht të padeklaruar. Nga vërtetimet me bizneset, veçanërisht në sektorët e shërbimeve dhe turizmit, konfirmohet se sistemet jofleksibile të kontributeve sociale dhe shëndetësore janë shtytësit kryesorë të kësaj problematike. Punëdhënësve u kërkohet të paguajnë kontribute të plota mujore si për punonjësit me kohë të pjesshme ashtu edhe për ata që punojnë vetëm disa ditë në muaj. Për më tepër, punësimi i padeklaruar kontribuon në normat e larta të qarkullimit të punonjësve, veçanërisht në sektorin e turizmit, i cili lufton të mbajë punësimin me kohë të plotë gjatë gjithë vitit për shkak të natyrës së tij sezonale. Për të trajtuar këto çështje të ndërthurura, mund të lehtësohet pagesa e kontributeve proporcionale shoqërore dhe shëndetësore për punësimin me kohë të pjesshme, duke avokuar për pagesë pune/orë. Për përcaktimin e tarifave mujore, javore ose ditore, duhet mbajtur parasysh që punëtorët duhet të marrin kompensim të barabartë me atë të një punonjësi me kohë të plotë, siç kërkohet nga ligjet e punës të vendit. Pagesa jashtë orarit nuk duhet të përfshihet në llogaritjen e pagës minimale, pasi përbën mospërputhje të kërkohet punë jashtë orarit për të MFE DPT ISSH Afatmesëm 3 përmbushur pagën minimale ligjore. Punonjësit me kohë të pjesshme duhet

të marrin një pagë minimale në përpjesëtim me orët e tyre të punës.²⁴

Të tjera

- » Ngritja e një grupi pune ku theks t’i vihet trajtimit të dietave dhe shpërblimeve, të cilat janë tashmë të vjetra si nocione dhe trajtimi fiskal duhet të rregullohet për të patur trajtimin e duhur fiskal. Gjithashtu qeveria të suportoje në lidhje me fiskalizimin e pagave, d.m.th. sistemi CATS të lejojë llogaritjen e pagës bruto dhe neto. Sistemi t’i lejojë biznesit të ngarkojë dokumentin e pagave nga excel direkt në sistem, duke qënë se pagat marrin një kohë të madhe të punës së financës. Suport mund të jepet përmes granteve apo garancive për sektorë që kanë potencial e nevojë për mbështetje. Mund të ofrohet mbështetje në këtë drejtim dhe për ndarjen e kostos së trajnimit për punonjësit në mënyrë që të mbahen sa më gjatë në punë.
- » Në sistemin fiskal të mund të suportohet sistemi TIPS duke e raportuar veçmas, pasi shumica e turistëve të huaj preferojnë të paguajnë me kartë. Në rast se sistemi TIPS do të futej në sistemin fiskal, ai do të hynte në xhiron e biznesit, gjë e cila do të shoqërohej edhe me pagesën e tatimit.
- » Duke synuar uljen e kostos së përdorimit të kartave të krediti, rritja e numrit të transaksioneve është një nga kriteret kryesorë për uljen e kostove të tyre, por zgjidhja më e mirë do të ishte ngritja e një sëitç kombëtar-operator vetting i cili nuk mbart kostot e operatorëve ndërkombëtarë. Shoqata Shqiptare e Bankave dhe bankat tregtare, duhet të angazhohen në mënyrë proaktive në këtë drejtim duke qënë se BSH e ka udhëzuar vazhdimisht këtë element tek bankat.

SUGJERIMET E SEKRETARIATIT TË KIMBI STRATEGJINË BIDS 2021-2027 – QERSHOR 2021

» Qëndrueshmëria, harmonizimi dhe thjeshtimi i masave të politikës fiskale ndaj investimeve dhe NMVM – mund të jetë momenti për të menduar një “reformë fiskale gijotinë/reformë thelbësore”: Stabilizimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor fiskal. Ndryshimet e shpeshta përgjatë këtyre viteve, edhe pse në shumicën e rasteve kanë konsistuar në parashikimin e incentivave dhe masave lehtësuese për kategori të caktuara tatimpaguesish, kanë krijuar shumë përjashtime dhe fragmentime tatimore, rregulla dhe kriteret specifike të zbatueshme sipas kategorive të tatimpaguesve, të cilat nëse nuk mirëadministrohen mund të krijojnë efektin e kundër dëshiruar sa i përket formalizimit të ekonomisë. Mirëadministrimi i tyre në afatshkurtër kërkon: (1) dedikimin e burimeve shtesë, një administratë efikase, e shpejtë, joburokratike dhe e përgjegjshme; (2) transparencë të incentivave sektoriale të zbatueshme për investitorët dhe palët e interesuara nëpërmjet përgatitjes së një inventari sistematik (të përditësuar në mënyrë periodike). Ndërsa në një kontekst afatmesëm, sugjerohet rishikimi themelor i ligjeve të tilla si: ligji 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore”, ligji 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe veçanërisht ligji 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i cili ka qënë edhe më herët objekt diskutimi. Këtu bëhet fjalë veçanërisht për procedurat tatimore dhe udhëzimet përkatëse të cilat janë ndryshuar më shumë se 17 herë sa herë që është parë e nevojshme të adresohet një problematikë ad-hoc dhe jo në mënyrë integrale duke krijuar mospërputhje në disa raste midis ligjit dhe udhëzimeve 4 reflekton si duhet kontekstin ekonomik të bizne-

sit dhe të individëve. Ky komponent është mjaft i rëndësishëm dhe duhet të jetë pjesë e angazhimit serioz të qeverisë dhe MFE si institucioni përgjegjës për SZHBI për të mundësuar që përpjekjet të japin rezultatin e parashikuar si edhe të rrisin besimin ndaj institucioneve dhe qeverisjes pas krizës shëndetsore COVID-19 dhe tërmetit të nëntorit 2019.

» Vijueshmëria midis strategjisë së re që propozohet dhe iniciativave ligjore dhe rregullatore të ndërmarra vitet e fundit për të përmirësuar klimën e investimeve, duke bërë transparencën e statusit të tyre aktual për palët e interesuara të përfshira. Ndërsa Strategjia eidenton lidhjen e saj me objektivat strategjikë të qeverisë shqiptare dhe kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, nuk eidenton disa nga iniciativat ligjore tashmë në proces si psh: draft-ligjin “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-ve Inovative”, apo draft-ligjin e “Unifikuar të Investimeve” të cilat janë konsultuar më herët gjerësisht dhe në mbledhje të veçanta të KI. Nuk është e qartë nëse vizioni strategjik në lidhje me kuadrin ligjor orientohet drejt zgjatjes së afatit si deri më sot të ligjit 55/2015 “Për Investimet Strategjike” dhe mbajtjes në fuqi të ligjit 7764/1993 “Për Investimet e Huaja” apo miratimit të draftit tashmë të përgatitur me asistencën e IFC të Ligjit të Unifikuar të Investimeve. Gjithashtu megjithëse Strategjia ka një pjesë të veçantë raportimi për ecurinë e TEDA (Zonat e Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjik), nuk paraqet një qasje të konsoliduar strategjike apo plan, mbi mënyrën e vënies në zbatim të tyre sipas kuptimit të ligjit, thithjes së investimeve të huaja në këtë fushë dhe as një ndërlidhje me masat strukturore siç është krijimi në 2019 i Korporatës së Investimeve Shqiptare.

PROPOZIME MBI RIMËKËMBJEN EKONOMIKE – SHQIPËRIA POST COVID-19 – QERSHOR 2020

Në kontekstin edhe të analizave dhe sugjerimeve të mëparshme të KI këto 5 vite, vlen të nënvizohen elementet e mëposhtëm të cilat do të mund të krijojnë një momentum pozitiv dhe një paketë konkurruese edhe në raport me vendet e rajonit sikurse kërkohet veçanërisht nga shoqatat dhe dhomat e biznesit, si edhe do të konvergojnë me ambiciet për miratimin e ligjit të unifikuar të investimeve brenda 2020.

- » Rëndësia e formalizimit të ekonomisë (analizuar nga KI që prej 2015), si një sfidë e rëndësishme për vendin dhe veçanërisht për sektorë si turizëm, bujqësi, shërbime, etj., në të cilat informaliteti shfaq tipologji specike dhe është faktor thelbësor që kërcënon konkurrencën e ndershme. Krizat e njëpasnjëshme që lidhen me situatat e krijuara në vend pas tërmetit dhe gjatë Covid-19 krijojnë premisa për rritjen e informalitetit por ndërkohë edhe vështirësojnë që ndihma e qeverisë të jepet në kohë tek përfituesit.

Stabilizimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor fiskal.²⁵ Ndryshimet e shpeshta përgjatë këtyre viteve, edhe pse në shumicën e rasteve kanë konsistuar në parashikimin e incentivave dhe masave lehtësuese për kategori të caktuara tatimpaguesish, kanë krijuar shumë përgjatime dhe fragmentime tatimore, rregulla dhe kritere specifike të zbatueshme sipas kategorive të tatimpaguesve, të cilat nëse nuk mirëadministrohen mund të krijojnë efektin e kundër dëshiruar sa i përket formalizimit të ekonomisë. Mirëadministrimi i tyre në afatshkurtër kërkon:

²⁵ Kjo lidhet veçanërisht me procedurat tatimore dhe udhëzimet përkatëse të cilat janë ndryshuar më shumë se 17 herë sa herë që është parë e nevojshme të trajtohet një çështje ad-hoc dhe jo në mënyrë integrale, duke krijuar kështu mospërputhje në disa raste midis ligjit dhe këtyre udhëzimeve.

- o dedikimin e burimeve shtesë, një administratë efikase, e shpejtë, joburokratike dhe e përgjegjshme;
- o transparencë të incentivave sektoriale të zbatueshme për investitorët dhe palët e interesuara nëpërmjet përgatitjes së një inventari sistematik (të përditësuar në mënyrë periodike).

Ndërsa në një kontekst afatmesëm, sugjerohet rishikimi themelor i ligjeve të tilla si: ligji 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore”, ligji 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe veçanërisht ligjit 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i cili ka qenë edhe më herët objekt diskutimi dhe nuk reflekton si duhet kontekstin ekonomik të biznesit dhe të individëve.

Theksojmë se përgatitja e ligjeve të reja në këto fusha do të mundësojë së pari një sistem tatimor të përgjegjshëm kundrejt nevojave që ka ekonomia për formalizimin e ndërmarrjeve dhe të individit. Nga ana tjetër ato do të mundësojnë: (i) një koherencë më të madhe të tyre me kërkesat e biznesit dhe procedurat e dëshiruara nga sipërmarrja; (ii) shmangien e mospërputhjeve ekzistuese me legjislacionin e tyre sekondar i cili vështirëson zbatimin e duhur në praktikë; (iii) thjeshtimin e mëtejshëm të procedurave biznes-administratë në dritën e reformës së fiskalizimit që pritet të zbatohet nga muaji shtator dhe zhvillimeve teknologjike; (iv) si edhe do t'i hapte rrugë reformës në fushën e tatimit të të ardhurave duke vendosur barazinë dhe drejtësinë e sistemit fiskal në themel të tatimit të të ardhurave të individëve dhe korporatave, sa i takon: njohjes së shpenzimeve të zbritshme në favor të individëve, fashave të të ardhurave dhe mënyrës së tatimit të tyre, zgjerimit të afatit për bartjen e humbjeve tatimore për bizneset nga 3 vjet në 5-7 vjet duke mbështetur investimet e reja “greenfield” pa varësisht shumës fillestare të investimit.

Të tjera

Reforma fiskale me fokus konkurrencën, stabilitetin, hyrjet e kapitalit, transparencën në përdorimin e fondeve publike

- » Zhvillimi i një reforme fiskale që promovon konkurrencën e fokusuar në a) uljen e taksave për t'u bërë konkurruese midis vendeve të rajonit, b) kjo masë duhet të zgjasë të paktën 5 vjet në mënyrë që bizneset të mund të planifikojnë investime afatgjata, c) normë më të ulët të taksave për strategjitë. investimet. Mënyra të tjera mund të jenë inkurajimi i tatimpaguesve që paguajnë paraprakisht taksat vjetore duke zbritur një përqindje të caktuar të taksave. Të konsiderohen shpenzime të zbritshme, donacione publike, shkolla, spitale etj. (AMCHAM/DIHA/Dhoma Kombëtare e Diasporës).
- » Miratimi sa më i shpejtë i strategjisë afatmesme të të ardhurave, me fokus të veçantë në “shpenzimet tatimore”; vendosjen e kufijve kohorë për masat e lehtësimi të taksave për periudhën COVID-19 dhe rimbursimin në kohë të TVSH-së (Delegacioni BE).
- » Procedurat transparente për vlerësimin dhe miratimin e të gjitha investimeve që përfshijnë fonde publike; forcimi i kapaciteteve institucionale për të monitoruar dhe vlerësuar rrezikun fiskal të PPP, kontratat koncesionare dhe kompanitë shtetërore (Delegacioni i BE).
- » Orientimi i mbështetjes fiskale nga masat emergjente në programet e përkohshme të krijimit të vendeve të punës: a) Lehtësimi i pjesëmarrjes së SME-ve në prokurimet publike, b) punët publike me theks te SME-të, c) ndërtimi i programeve të mbështetjes së SME-ve të fokusuara në nxitjen e rritjes së produktivitetit, d) aplikimi zbritje tatimore deri në 80% të kostove në këto zona

deri në një tavan maksimal (kufizimi mund të jetë qarkullimi/numri i punonjësve të një kompanie) (BB).

- » Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi të përkallëzimit të taksave bazuar në pasurinë dhe bilancin e gjendjes (BSH).
- » Rishikimi i plotë i performancës për të gjitha marrëveshjet koncesionare për asetet kombëtare të dhëna me koncesion. Verifikime të detajuara për të vërtetuar nëse janë plotësuar ose jo kushtet e planit të biznesit të propozuar. Verifikime për përmirësim në drejtim të rritjes së vendeve të punës dhe rritjes së përfitimit publik (Konfindustria).

MBI NDËRVEPRIMIN BASHKI-BIZNES – JANAR 2020

REKOMANDIMI 1.

Harmonizimi i legjislacionit në fushën e taksave dhe tarifave vendore me legjislacionin e ri për vetëqeverisjen vendore. Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar) duhet të harmonizohet me ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Është e nevojshme: a. Shfuqizimi i nenit 22/5 paragrafi 2 në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006. b. Saktësimi i kategorisë së taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë, nëse është taksë kombëtare apo taksë vendore. Duke u nisur nga ndryshimet e shumta dhe të shpeshta që ka pësuar ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore” duke u ndryshuar në total 17 herë për vetëm 39 nene, në afatgjatë sugjerohet hartimi i një ligji të ri dhe gjithëpërfshirës që të garantojë unitetin e normave juridike dhe koherencën e tyre në një kontekst afatgjatë.

MBI FORMALIZIMIN DHE KONKURRUESHMËRINË NË SEKTORIN E TURIZMIT – TETOR 2018

REKOMANDIMI 1.

Finalizimi dhe miratimi i Strategjisë për Turizmin. Përafrimi i objektivave ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me veprimet, masat konkrete dhe agjencitë përgjegjëse për të trajtuar informalitetin në këtë sektor. Konkretisht, përcaktimi i etapave të qarta të formalizimit për të mundësuar objektivin e draft-strategjisë së turizmit: “Regjistrimi i 80% të akomodimit familjar (dhoma, apartamente, shtëpi) deri në vitin 2022”. Përcaktimi i aksioneve dhe metodave konkrete që adresojnë problematikat e formalizimit (identifikimit dhe regjistrimit), mund të bëjnë realist këtë objektiv të strategjisë.

REKOMANDIMI 3.

Modeli i biznesit dhe tiparet e informalitetit janë të larmishme sipas tipologjisë së destinacioneve turistike. Duke qenë se informaliteti në sektor është sistemik, sugjerohet që strategjitë e formalizimit mund të specifikohen dhe grupohen sipas tipologjive të mëposhtme:

- » Grupi 1 - formalizimi/regjistrim + kontrolle tatimore për rastet kur industria e ndërtimit në një masë të caktuar është shndërruar në industry turistike, duke dhënë me qira në mënyrë masive apartamente për turistët. Impakti nga humbjet e shkaktuara nga ky aktivitet i paformalizuar në buxhetin e shtetit është i konsiderueshëm (p.sh. në qytetet kryesore si Vloja, Durrës, Shëngjin, Saranda etj.)
- » Grupi 2 - regjistrimi i strukturave të vogla akomoduese (të cilat nuk ushtrojnë aktivitete të mirëfilltë ekonomik) vetëm për qëllime të turizmit dhe jo për qëllime fiskale.

(p.sh. në destinacionet historike Gjiro-kastër, Berat, Korçë). Sidoqoftë këto mikro-biznese duhet të mbeten objekt i inspektimeve nga autoritetet vendore dhe qendrore sa i përket përputhshmërisë së tyre me standardet higjeno-sanitare dhe objekt i asistencës për t’u shndërruar gradualisht në aktivitete ekonomike të mirëfillta.

- » Grupi 3 - formalizimi i aktiviteteve të promovuara nëpërmjet platformave online si Airbnb në qytetet kryesore si Tirana, Durrës etj. nëpërmjet vetëdeklarimit të të ardhurave si të ardhura personale në masën 15% sikurse është bërë me dije nga Udhëzimet Teknike të DPT.

REKOMANDIMI 5.

Inkurajimi i pagesave elektronike përmes përdorimit të terminaleve POS do të ndikojnë në uljen e ekonomisë së fshehtë në turizëm, do të rrisnin pajtueshmërinë e biznesit me tatimet dhe do të kontribuonin në rritjen e transparencës dhe reputacionit të ofertës shqiptare në turizëm, sidomos për të huajt.

- a) Mënyrat e përballimit të kësaj sfide duhet të jenë objekt diskutimi të mëtejshëm me BSH, bankat e nivelit të dytë dhe MFE-në, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme dhe shmangien e kostove shtesë për bizneset, sidomos për mikro-bizneset. Praktika ndërkombëtare ofron disa masa që mund të ndiqen.
- b) Përveç sa më sipër, zbatimi në praktikë i rregullave mbi kategorizimin /klasifikimin e strukturave akomoduese, sipas dispozitave të vendimit Nr. 730 datë 20.10.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifën, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave të akomodimit”, të cilat e bëjnë të detyrueshëm përdorimin e POS në hotele/resorte me 4/5 yje, do të ndihmonin në formalizim.

konsolidohet Regjistri Kombëtar i Sipërmarrjeve turistike.

REKOMANDIMI 9.

Ndryshime në Udhëzimin Nr. 24, të datës 02.09.2008, të MFE-së “Për procedurat tatimore” dhe VKM Nr. 96, datë 17.02.2010. Qëllimi i këtyre ndryshimeve duhet të jetë lehtësimi i të bërit biznes dhe gjetja e zgjidhjeve të reja, si p.sh. duke bërë të mundur lëshimin e një “kuponi përmbledhës” të lidhur me një “listë të hollesishme të porosive” për shërbimet që ofrohen në MFE/DPT/Shoqatat e Biznesit në Turizëm Afatshkurtër 5 strukturat akomoduese, duke e bërë më të lehtë procesin e formalizimit. Këto ndryshime do të përmirësonin administratën tatimore në monitorimin e pajisjeve fiskale, çastin kur lëshohet kuponi etj. dhe do të ofronin një model të përshtatur për bizneset që operojnë në fushën e turizmit.

POLITIKAT INCENTIVUESE PËR NXITJEN E INVESTIMEVE: SHQIPËRIA DHE VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR -- PRILL 2016

Ofrimi i incentivave të prekshme për investitorët dhe bizneset

- » Të vlerësohet nga Ministria e Financave në diskutim me grupet e interesit heqja e tatimit për pjesën fitimeve që ri-investohet, si një masë nxitëse për investitorët aktualë, vendas dhe të huaj. Në lidhje me këtë, kërkohet një analizë e diskutim më i gjerë lidhur me efektet, mënyrën e zbatimit dhe kapacitetet e administratës dhe bizneseve për monitorimin e destinacionit të ri-investimeve.
- » Të vlerësohet nga Ministria e Financave në diskutim me grupet e interesit shtrirja e periudhës së mbartjes së humbjeve tatimore mbi 3 vjet.

REKOMANDIMI 6.

Identifikimi i të gjitha strukturave akomoduese, siç përcaktohet në Ligjin nr. 93/2015, duke përfshirë edhe apartamentet/vilat dhe bujtinat, të cilat ushtrojnë aktivitet ekonomik në fushën e turizmit, nëpërmjet një fushate të koordinuar midis DPT-së, MTM-së, Njësive rajonale të MTM-së dhe Bashkive. Për një periudhë tranzitore, një zgjidhje që mund të merret në konsideratë është regjistrimi i “thjeshtë” i bujtinave, që ofrojnë shërbime akomoduese në mënyrë rastësore dhe për një periudhë të kufizuar ditësh në destinacionet kulturore/historike, në baza vjetore, si struktura akomoduese me NUIS/ID, por jashtë regjimit të personit fizik për qëllime taksash dhe tatimesh në nivel qendror dhe vendor. Ndërkohë, këto subjekte të jenë objekt i inspektimeve në lidhje me masat kundër zjarrit dhe kushtet higjeno-sanitare.

REKOMANDIMI 7.

Klasifikimi i strukturave të akomodimit Zbatimi i dispozitave të Ligjit 93/2015 dhe modaliteteve të përcaktuara me Rregulloren “Për Kushtet, Kriteret, Tarifën, Afatet dhe Procedurën Për Klasifikimin e Strukturave Akomoduese”, të miratuara me anë të VKM-së Nr. 730, datë 20.10.2016 është domosdoshmëri për të përshtatur më tej masat - sidomos politikat fiskale - për trajtimin e informalitetit në sektor.

REKOMANDIMI 8.

Identifikimi dhe regjistrimi i strukturave akomoduese të konsiderojë një instrument si p.sh. një “etiketim” të thjeshtë të operatorëve formalë në sektorin e turizmit, që paguajnë rregullisht të gjitha taksat dhe tatimet. Ky etiketim është përdorur në vendet fqinje si Greqia/Kroacia si një masë kalimtare drejt formalizimit të plotë të sektorit. Ky është një hap paraprak deri sa të

Shtojca V MË SHUMË MBI PRODUKTIVITETIN

PRODUCTIVITY AND FISCAL STANCE

Productivity at the country level reflects the way resources (labor and capital) are allocated across sectors and firms. Misallocation of resources within a country is found to be an important source of differences in productivity. Tax policy and tax administration are important factors in addressing productivity challenges. Tax systems can boost productivity by reducing resource allocation distortions. Fiscal policy can often affect the allocation of capital and labour, inducing productivity growth (IMF, 2017).


The low productivity of the Albanian economy is mirrored in the low competitiveness of the economy. Albania scores poorly in the competitiveness index, especially in the dimensions related to business sophistication, organizational culture or research and development. Investments have not been able to transform

the production structure of the country and the transition to industries with high levels of value-added or productivity. As a result, businesses seem to be stuck in a low productivity trap, which needs to be addressed carefully as part of the structural reforms (Xhepa and Liperi 2021).

The level of productivity among sectors, or within a sector is important in defining policies to tackle it (IMF, 2017). The Investment Council surveyed the diversity of productivity of labor among 601 companies at the national level. One in two companies reports having productivity similar to that of its competitors at the sectoral level. However, when companies were asked to indicate their productivity against their competitors in the regional market, one in two companies reported having a lower labour productivity than their competitors (see Figure 1).

Figure 1. Firms' productivity vs. competitors


Defining labour productivity as the (monetary) value that the company receives from a working day of your employees, how would you rate their productivity in relation to that of other companies in the sector where you operate:



Source: Investment Climate Survey - IC

The perception that productivity as compared to competitors is similar does not apply to all sectors. Three patterns of labour productivity variation at the sectorial level were observed. There are sectors with a structure dominated by companies reporting to be leaders in the productivity of labour comparatively to the rest of the firms in the sectors, such as energy and ICT sector. Traditional sectors such as agriculture, trade, construction, or services for which companies report to perceive no productivity dispersion at the sectoral level, responding that productivity among different companies is of the same level. These sectors manifest features of a perfectly competitive sector, with many similar firms operating. Productivity per firm characteristics shows that firms operated for more than 10 years in the market, as well as companies with high number of employees (higher than 250) self-report that a productivity of labour is higher than that of competitors. Among SMEs

Defining labour productivity as the (monetary) value that the company receives from a working day of your employees, how would you rate their productivity in relation to that of foreign companies you cooperate with:




the productivity of labour is reported similar to that of competitors.

PRODUCTIVITY ANALYSES USING ENTERPRISE SURVEY DATA

The enterprise survey data provides consolidated sectoral balance sheet data, which were used to analyse productivity.

We used the sectorial output and number of employers at year-end to estimate **labour productivity**. The average value added created per employee for the period 2019-2022 amounts to 11,888 Euro/Year. Traditional sectors and the public sector *have a productivity nearly to the national average. This category includes the construction, processing industry, transport, trade, accommodation, and food industry (tourism included), which have a value-added per employee around the national average.* **Sectors with the highest labour productivity (measured as value added per employee) are extractive industries, energy, professional services, real estate sector, followed by the ICT sector. (see figure 2)**

Figure 2. Average Labour Productivity per Employee (in Euro, Annual 2019-2022)

Source: Enterprise Survey (ASN) and IC own calculations.


The dynamics of labour productivity, measured as the average growth rate of value-added created per employee during 2019-2022, shows that, on average, labour **productivity among all sectors has increased** by 11% (see Appendix 1). Sectors that have high productivity in value show a slowdown in productivity for 2019-2022; energy, ICT and construction are among the sectors with a slowdown in **productivity of labour**. Among the fastest-growing productivity sectors are accommodation and food (tourism), processing and extracting industry followed by the recreation and entertainment sector. The health sector is also experiencing an increase in productivity, followed by the public administration, defence and social protection sectors.

Sectors that have the highest labour productivity, such as energy and ICT, are also sectors with new investments and updated technologies. When asked about productivity if compared to foreign competitors in the IC survey, the perception that companies have lower productivity than the **foreign companies** they compete with is dominant even at the sectoral level. Companies operating in the construction, trade, ICT, and tourism sectors perceive a productivity that is aligned and similar to their foreign competitors. Companies that operate in agriculture, energy, services, and industry report have a disadvantage compared to their foreign competitors that relate to low productivity of labour. Previous research does confirm the low productivity of labor in Albania comparably to the


regional economies of Albania. Labour productivity, measured as the ratio of the total output to the number of employees, is half that of economies in the region (e.g. Serbia and Montenegro) and even lower if compared to Bulgaria or Croatia (see Figure 2).

Given the fact that labour productivity is closely related to technology, companies through the IC survey were asked to identify if they face situa-

tions when work needs to be stopped due to technological problems. 72% of companies reported that they face such problems, for 94% of respondents, the production process stopped due to technology problems for 30 to 60 minutes. Data from the Enterprise Survey (2019-2022) confirms a positive (and significant) correlation between labour productivity and investments (correlation coefficient of 0.37).

Figure 3. Labour productivity compared to regional economies

Source: WüW Productivity of Western Balkan Countries and Xhepa and Liperi (2022)


Figure 4. Labour productivity vs. Investment Productivity (2019-2022)

Source: Enterprise Survey (ASN) and IC own calculations.

R&D investments are among the most important investments in improving productivity. Companies were asked to identify if they invest in R&D investments and if yes, they were asked to indicate if having a dedicated budget for that purpose. Only 6% of companies have confirmed to have a budget dedicated to R&D. In 2024 the propensity of companies investing in R&D has declined by 8% (14% of companies have confirmed to invest in R&D in 2021). 54% of companies have declared to have an ad-hoc budget for R&D, while 40% report not having a budget at all. Companies were asked to identify their commitment to innovation as part of their company strategy. 54% of companies reported being very dedicated/concerned to innovation, 34% reported having some attention/dedication to innovative business practices, 21% of companies report not having an interest at all. *The share of*

companies having innovation as part of their company strategy has declined noticeably if compared to the same survey performed in 2021. At the national level, on average share of labor cost to value added is 42%, and capital (investments) is 31%. Sectors in which value-added share from investments is higher than that of labour are real estate, energy, water, and waste management. In other sectors, such as the accommodation and food (tourism) sector, extractive industries, processing industry, ICT, trade, and transport, the share of investments in value-added and labour in value-added are almost proportional. Labour and capital are combined in value creation in a one-to-one ratio, causing high conditionality of productivity labour. Un-skilled or unproductive labour would undermine the productivity of capital, and similarly, unproductive technology of production would cause labour productivity to be sub-optimal.

Figure 5. Share of labor and capital (investments) in value-added (average 2019-2022)



Source: Enterprise Survey (ASN) and IC own calculations.

To further understand how interlinkages between labor and capital affect sector productivity, the stochastic frontier methodology was used. The estimation assumes that inputs are combined through a Cob-Douglas production technology to produce output. The optimal output level that can be produced given inputs, labour, and capital (or investments) is called the production possibility frontier (PPF).

$$Output_{it} = A * Labour_{it}^{\beta_1} * Capital_{it}^{\beta_2} + v_{it} + \varepsilon_{it} \quad (1)$$


The production possibility frontier was estimated using data from Enterprise Survey, where output was production (in million Lek), labour was measured by expenses of the company on employees (including wage, social insurance, and other expenses on staff), the capital was measured by total investments (depreciated and in million Lek as reported in the balance sheet). Data were provided at the sectorial level for the time frame 2019-2022. The stochastic frontier estimations were performed using the Maximum Likelihood method with panel data. This estimation generates and the maximal expected output. Using the inverse Shepard output efficiency formula, the relative loss in output due to inefficiency is given by the stochastic term.

$$D_0(x^0, y^0) = \frac{Actual\ Output}{Maximal\ Expected\ Output} = v_{it} \quad (2)$$


After the PPF is estimated, actual production data are compared with the frontier, and the distance of real data from the PPF determines the sector efficiency (or inefficiency). If sec-

tors are found to be at a lower production level than the optimal, there is space for efficiency gain improving the productivity of resources or resource allocation. Results show that at the national level, the efficiency is lower than optimal by 24%. *Combining resources (materials, labour, and capital) more productively will enable the economy to produce 24% more output with the same resources. The optimal output level produced is driven by labour productivity, and investments in technology and assets have a weak impact on output level if compared to labour.* Sectors that have reached closer to the production possibility frontier are the processing industry (93%), construction (92%), and professional services followed by energy. The sector that is low at value creation and as a result very inefficient is trade, water, and waste management followed by the entertainment and recreation sector and real estate sector. The tourism sector, ICT and extractive industries inefficiencies are close to the national level and they could improve their output level through productivity by at least 20%. The deviation of output from the optimal frontier is *in line with the business perception on productivity, industries (such as energy and construction) where firms report to have high productivity are on the optimal production frontier, while traditional sectors (tourism, industry) report productivity improvement space similar to the distance from the optimal production. The high inefficiency in trade, entertainment and recreation or real estate sector shows a deviation that is more a misallocation of resources.*

Figure 6. Sectorial Efficiency and Inefficiency Score - Stochastic Frontier Estimations



Appendix 1. Average Change Rate of Labour Productivity (In %, Yoy 2019-2022)



Appendix 2. Stochastic Frontier Analyses

Variables	-coefficients	t-statistics
Intercept	0.233	14.512***
Labour	0.0738	14.454***
Capital		
Primary Materials	0.0087	2.169**
Investments	0.0039	1.78*
Investment in Technology	0.00049	0.0191
Public administration and defence; compulsory social security	0.0547	6.154***
Arts, entertainment and recreation	0.1204	16.648***
Accommodation and food service activities	0.0492	6.87***
Education	0.0698	7.3551***
Electricity, gas, steam and air conditioning supply	0.0193	1.657
Human health and social work activities	0.0351	4.512***
Information and communication	0.0416	6.768***
Mining and quarrying	0.0157	3.091***
Manufacturing	0.0375	4.2877***
Construction	-0.801	-9.214***
Other service activities	0.0374	4.733***
Professional, scientific and technical activities	-0.6192	-7.824***
Real estate activities	-0.436	-6.8701***
Transportation and storage	0.026	3.766***
Trade	0.018	1.719*
Water supply, sewerage, waste management	0.0814	11.081***
	0.756	
Mean Efficiency	62.034	
Log Likelihood Value	64	
Number of Observations	16	

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council

